

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**TRANSKRIPT**

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,  
TË MBAJTUR MË 13 NËNTOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 13. 11. 2003. GODINE

---

**NËNTOR - NOVEMBAR**  
**2003**

---

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

✓  
**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësi në Kosovë (2003/31),
3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve,
4. Përgjigjet në pyetjet e deputetëve.
5. Propozimi i rendit të ditës për Seancën plenare me 20 nëntor 2003:
  - 5.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Sportin (2003/27),
  - 5.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kadastër (2003/30),
  - 5.3 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transportin rrugor (2003/32).

**ДНЕВНИ РЕД**

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Прво разматрање Нацрта закона о здравству на Косову (2003/31),
3. Разматрање препоруке Комисије за судскапитања, законодавство и Уставни оквир о именовану судија и тужиоца,
4. Одговори на посланичка питања.
5. Предлог дневног реда за пленарну седницу за 20 новембар 2003:
  - 5.1 Друго разматрање Нацрта закона о спорту (2003/27),
  - 5.2 Друго разматрање Нацрта закона о катастру (2003/30),
  - 5.3 Прво разматрање Нацрта закона о путном транспорту (2003/32).



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**AGENDA**

1. Approval of the minutes from the previous meeting,
2. First reading of the Draft Law on General Health of Kosovo (2003/31),
3. Review of the recommendations by the Committee of Judicial, Legislation and Constitutional Framework matters on appointment of the Judges and Prosecutors,
4. Answer to the deputy questions.
5. Proposal for the Agenda of the Plenary Session on 20 November 2003:
  - 5.1 Second reading of the Draft Law on Sport (2003/27),
  - 5.2 Second reading of the Draft Law on Cadastre (2003/30),
  - 5.3 First reading of the Draft Law on Road Transport (2003/32).

# TRANSKRIPT

## I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 13 NËNTOR 2003

Seanca Plenare e Kuvendit të Kosovës, u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës Prishtinë.

Seancën Plenare e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues Gojko Saviq, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 10,00.

### KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmengjes dhe mirëseerdhët në Seancën e radhës plenare.

Mirëseardhje ministratve dhe në veçanti ministreshës Resmije Mumxhiu, sepse ajo sot e ka përgjegjësinë kryesore.

Shpresoj se materialet ju janë shpërndarë me kohë.

Prandaj, fillojmë menjëherë me realizimin e rendit të ditës.

Pikë e parë është: – Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Shpresoj se ndjekim të njëjtën ecuri sikur që kemi ndjekur deri tani: – ata që kanë vërejtje ose diç tjetër, me shkrim t'i bëjnë ato.

Pastaj kemi: - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësi në Kosovë.



Ftoj ministreshën Resmije Mumxhiu që ta paraqesë në parim fjalën e saj dhe ta arsyetoj Projektligjin.

Foltorja është e juaja, ministreshë.

### RESMIJE MUMXHIU:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Përshëndes fillimin e debatit në Parlament për miratimin e ligjit të shëndetësisë së Kosovës, dokument tejet i rëndësishëm ligjor për kujdesin shëndetësor të qytetarëve, për sektorin shëndetësor dhe për Kosovën në tërësi.

Fillimisht dua të theksoj kuptimin se konteksti aktual i shëndetësisë në Kosovë ka qenë faktor e sencial me rastin e vendosjes për strukturën themelore të sistemit shëndetësor në Kosovë që propozohet me këtë Projektligj.

Duke u nisur nga kjo, në pika të shkurtëra do të përmendi disa nga karakteristikat kryesore të shëndetësisë së Kosovës gjatë katër viteve të pasluftës në liri.

Është arritur përparimi në të gjitha fushat e kujdesit shëndetësor, duke siguruar kujdesin shëndetësor të vazhdueshëm dhe pa pagesë për të gjithë qytetarët. Kujdesi shëndetësor zbatohet duke u mbështetur në ruajtjen dhe përparimin e gjendjes së tërësishme shëndetësore mbi baza të arritura bashkëkohore mjekësore dhe sigurimit të kushteve për sendërtimin e tyre në praktikë.

Është arritur organizimi institucional dhe kadrovik i institucioneve shëndetësore në nivelin komunal, regjional dhe qendror nëpërmjet decentralizimit të mbështetur në efikasitetin e shtuar shëndetësor dhe ekonomik.

Janë arritur rezultate të konsiderueshme në përparimin e shëndetit.

- Dukshëm është zvogëluar mortaliteti i përgjithshëm në 5.2 promil;
- Mortaliteti perinatal i fëmijëve në 17.7 promil;
- Në masë të duhur është zvogëluar numri i sëmundjeve ngjitëse;
- Udhëhiqet politika e imunizimit aktiv;
- Dhe në mënyrë të vazhdueshme sigurohet shërimi i sëmundjeve të tjera jo të ngjitshme;
- Praktika e mjekësisë familjare, me mbështetje të kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor, ka filluar të japë rezultate të përmirësimit dhe kujdesit shëndetësor të popullatës;

- Furnizimet dhe zhvillimet kapitale, dukshëm janë përmirësuar;
- Ndonëse është ende shumë i vogël, konsumi është në rritje dhe siguron 52 dollarë për kokë të banorit; në sektorin publik 30 dollarë, ndërsa në atë privat 22 dollarë;
- Sektori shëndetësor mbështetet me 13.600 të punësuar, me një pjesëmarrje prej 2,9% në punësimin e përgjithshëm të Kosovës.

Megjithkëtë, përkundër këtyre të arriturave, sektori shëndetësor përballohet me një mori vështirësish të natyrës objektive dhe subjektive.

Mund të them se në përgjithësi nuk po sigurohen kërkesat themelore dhe përmirësimi i konsiderueshëm i nivelit shëndetësor që do të cilësohet me qëndrueshmëri dhe siguri financiare më të madhe satisfaksion të duhur të qytetarëve.

E gjithë kjo reflektohet me gjendjen shëndetësore ende jo të volitshme krahasuar me shtetet e tjera të Europës dhe të regjionit. Disa qasje të skajshme dhe dukuri në sektorin po e ashpësojnë edhe më tepër këtë situatë.

Infrastruktura ligjore, e cila është në fuqi, prezentohet me dy ligje të dizajnuara për një sistem të kaluar, më shumë rregullore dhe udhëzime parçiale administrative. Ky legjislacion nuk po siguron mjedisin për realizimin e sistemit efikas dhe ligjor.

Projektligji që gjendet para jush, përnga natyra dhe globalizmi i çështjeve do të siguron qëndrueshmëri dhe do të ndërtojë sistemin efikas dhe ligjor në sektorin e shëndetësisë.

Projektligji ka ngjallur interesim të duhur dhe ka siguruar mbështetje të gjerë nga diskutimi publik.

Zonja dhe zotërinj,

Objektiva kryesore që mbështetë Ministria e Shëndetësisë në Projektligj, qëndrueshmëria, e fikasiteti dhe ligjshmëria e sistemit, do të sigurohet nëpërmjet ndryshimeve që propozohen në rrafshet si vijon:

- Shtimi i racionalitetit efektiv nëpërmjet ndërtimit të konceptit të organizimit dhe të shfrytëzimit të resurseve njerëzore, të infrastrukturës dhe të produkteve farmaceutike;
- Përshtatja e popullatave zhvillimore në pajtim me zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës dhe mundësitë e qytetarëve;
- Dizajnimi i decentralizimit mbi bazat e efikasitetit të shtuar ekonomik dhe shëndetësor;

- Barazimi i sektorit privat dhe publik, si dhe sigurimi i mundësisë për forma të përziera të punës në shëndetësi;
- Ndërtimi i konceptit të financimit publik të shëndetësisë.

Bazuar në këto objektiva, Projektligji përcakton parimet themelore të sistemit, të kujdesit dhe të financimit shëndetësor si dhe mbështetje institucionale dhe juridike me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së sistemit dhe sundimit të ligjit.

Parimet kryesore mbi të cilat mbështetet Projektligji janë si vijojnë:

- Barazia, sigurimi i trajtimit korrekt, qasjes së lehtë dhe shpërndarjes së drejtë të burimeve për qytetarët;
- Cilësia, duke aplikuar standarde ndërkombëtare në shëndetësi;
- Ndërshtëria dhe përgjegjësia, duke siguruar transparencë të plotë;
- Gjithpërfshirja, duke siguruar kujdesin shëndetësor të barabartë për të gjithë qytetarët;
- Qëndrueshmëria, duke siguruar parandalimin e rrezikut financiar për qytetarët me rastin e shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore;
- Financimi kosto efektiv, duke siguruar shfrytëzimin efikas dhe racional të burimeve;
- Kontraktimet e shërbimeve shëndetësore dhe mbikëqyrjes;
- Bashkëfinancimi, duke përkrahë sistemin e referimit dhe shfrytëzimit më të përshtatshëm të shërbimeve shëndetësore nëpërmjet ndërhyrjes së bashkëpagesave të qytetarëve;

Mbështetja institucionale sigurohet dhe udhëheqet me zbatimin e politikave të kujdesit shëndetësor të cilat në këtë Projektligj i ndërmarrin institucionet e Kosovës si tërësi, institucionet shëndetësore, punëtorët shëndetësor dhe qytetarët.

Propozohet që në mënyrë institucionale kujdesi shëndetësor të zbatohet në nivel parësor, dytësor dhe tretësor. Kjo do të sigurohet me organizimin e veprimtarisë shëndetësore në kuadër të sektorit publik, sektorit privat dhe sektorit të përzier. Këtë sistem do ta mbështesë mjekësia familjare që duhet të mbulojë 90% të kujdesit shëndetësor të popullatës, si dhe mjekësia dytësore dhe tretësore nëpërmjet sigurimit të vëllimit të hospitalizimit në mesataren e pritur prej 110 epizodave të shërimit spitalor në 1000 banor me një trajtim mesatar të hospitalizimit në kohëzgjatje prej 8 deri 12 ditë.

Me këtë Projektligj financimi i kujdesit shëndetësor të qytetarëve vazhdon të sigurohet prej buxhetit qendror dhe buxheteve të komunave, por me ndërhyrje të sigurimeve shëndetësore themelore dhe private. Këto sigurime do të zbatohen nëpërmjet sigurimeve të detyrueshme dhe vullnetare, në agjencion të sigurimeve



shëndetësore dhe në fondin e sigurimeve shëndetësore të Kosovës, i cili duhet të fillojë punën në janar 2005.

Veprimtaria shëndetësore definohet si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, e cila duhet të sigurohet në kuadër të sistemit unik, funksionalisht të lidhur shëndetësor në nivel të Kosovës.

Mbështetja juridike konsiston në ushtrimin e obligimeve dhe përgjegjësisë në punë, kualifikimin, regjistrimin dhe licencimin e institucioneve dhe punëtorëve shëndetësor, të kontrollit dhe të dispozitave ndëshkuese në rast të mospërbushjes dhe shkeljes së detyrave të subjekteve shëndetësore.

Qëndrimi i Ministrisë së Shëndetësisë me këtë Projektligj mbështesin pakon e kujdesit shëndetësor të qytetarëve e cila parimisht duhet që të sigurojë përparimin dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve nëpërmjet sigurimit të themeleve të

shëndoshë të kualitetit të jetës me efekt të drejtpërdrejtë mbi familjen, aftësitë prodhuese, ruajtjen e mjedisit dhe rritjen e ekonomisë së Kosovës. Pakoja e kujdesit shëndetësor përmban:

- kujdesin shëndetësor të grupeve të posaçme të popullatës dhe të rinjve deri në 15 vjet dhe të moshuarve mbi 65 vjet;
- shëndetit reprodaktiv dhe parandalues;
- shëndetit të grupeve të veçanta të popullatës;
- sëmundjet të cilat rrezikojnë drejtpërdrejt jetën e qytetarëve dhe shëndetin e popullatës;
- sëmundjeve që shkaktojnë invaliditetin e lartë, rehabilitimin si dhe furnizimit të domosdoshëm.

Kjo do të thotë se sistemi i tanishëm i kujdesit shëndetësor nuk do të ndryshohet, por do të plotësohet dhe do të adaptohet ndaj kushteve dhe mundësive të Kosovës me plotësim të sistemit të sigurimeve shëndetësore.

Kujdesi parësor shëndetësor i përcaktuar me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë do të jetë pa pagesë dhe me kushte të barabarta për çdo qytetar. Do të jetë në përdorim sistemi i bashkëpagesave, që për qëllim parësor do të ketë parandalimin e hazardit moral, në formë të shfrytëzimit të panevojshëm të shërbimeve shëndetësore.

Krahas me këtë sistem të sigurimeve shëndetësore, duhet të përfshihet e tërë popullata dhe duhet të bazohet në parimet e obligueshmërisë në baza të reciprocitetit dhe solidaritetit.

Për një pjesë të popullatës materialisht të pasiguarur si dhe për kujdesin shëndetësor me interes të posaçëm për Kosovën, mjetet do të sigurojnë institucionet e Kosovës nëpërmjet buxhetit qendror dhe buxheteve komunale. Për të siguruar të drejtat e propozuara në këtë Projektligj, Kosova me institucionet e saj do të jetë e obliguar që të planifikojë dhe të sigurojë rrjetin dhe kapacitetet e institucioneve publike shëndetësore.

Në pajtim me këtë, me qëllim të sigurimit të barazisë së organizimit dhe të funksionimit të shëndetësisë kosovare, si tërësi të të drejtave themeluese mbi të gjitha institucionet publike shëndetësore do t'i marrë Parlamenti i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe kuvendi komunal.

Do të sigurohet barazia e plotë në zhvillimin dhe organizimin e shëndetësisë publike dhe private. Të dy këto segmente, në kuadër të sistemit unik dhe funksionalisht të lidhura të shëndetësisë do të ushtrjnë kujdesin shëndetësor. Para dy segmenteve do të parashtrahet kërkesa për rrespektimin e standardeve të të njëjta cilësore. Ato do të funksionojnë në kushte të njëjta të punës, të kualifikimeve, të mbikëqyrjes, të kontrollit dhe të çmimit efektiv të punës. Përcaktimi për zhvillimin e aktiviteteve në këto forma të veprimtarisë shëndetësore do të jetë vendimi i lirë i vetë punëtorëve shëndetësor.

Mbështetur në këtë, do të sigurohet që sektori publik dhe privat në mes veti të jenë komplementar në kuadër të sistemit unik shëndetësor.

Me qëllim të rumbullaksimit të infrastrukturës ligjore, e cila del nga Projektligji i shëndetësisë së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë ka në përgatitje dy projektligje të tjera sistimore – Projektligji mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor dhe Projektligji mbi sektorin privat në shëndetësi. Deri në fund të vitit do të paraqitet edhe nisma ligjore për fillimin e punës në projektligjet për sigurimin shëndetësor.

Deri në fund të tetorit të vitit 2004 Kuvendit të Kosovës do t'i dorëzohen për miratim edhe tetë ligje të tjera, të cilat do të përmbyllin kornizën legislative në këtë fazë të zhvillimit të legjislacionit. Paralelisht do të bëhet rishqyrtimi i rregulloreve dhe udhëzimeve administrative në fuqi dhe do të bëhet nxjerrja e të rejave në pajtim me ligjin e shëndetësisë së Kosovës.

Me këtë rast duhet të theksoj se me rastin e përpilimit të tekstit të Projektit të këtij dokumenti ligjor, në pajtim me cilësitë e legjislacioneve më bashkëkohore ndërkombëtare, është tentuar që të mos krijohet tekst voluminoz dhe tepër i detajizuar ligjor që do të paraqitte pengesë në periudhën e ardhshme me rastin e paraqitjes së nevojës për ndryshime të caktuara. Me këtë rast është patur parasysh veçanërisht periudha e transicionit nëpër të cilën po kalon Kosova.



Shpejt pas miratimit të ligjit të shëndetësisë së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë do të përgatisë edhe politikën zhvillimore për periudhën 2004-2009 si dhe strategjinë për zbatimin e saj.

Duke përfunduar, mbështes bindjen se diskutimet dhe propozimet tuaja do të plotësojnë fushat e veprimtarisë së këtij Projektligjit në të mirë të qytetarëve dhe Kosovës në tërësi.

Ju falemnderit për vëmendje.

(Duartrokitje)

### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit, ministreshë.

T'ju përkujtoj se debati është në parim dhe sipas radhës së paraqitur, fjalën e ka Nafije Gash, kryetare e Komisionit dhe anëtare e Kryesisë. Foltorja është e juaja...

### NAFIJE GASH:

Sajim bashkan, derli bakanllar, Kosova millet vekileri...

Ligji për shëndetësinë e Kosovës që po e shqyrtojmë sot, është një nga ligjet e rëndësishme që i ka munguar Kosovës e me të cilin, më mirë dhe në mënyrë më efikase do të rregullojë të gjithë lëminë e shëndetësisë, që është i një ndikimi të veçantë në përparimin dhe zhvillimin e Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Ky ligj na hapë rrugën që në një kohë të shkurtër të nxjerrim edhe ligje të tjera që do të rregullojnë fusha të rëndësishme të ndërlidhura me shëndetësinë, që të kemi qytetarë të shëndetshëm dhe të aftë, që të kemi një të ardhme më të sigurtë.

Kuptohet se lëmia e shëndetësisë nuk mund të rregullohet si e veçantë nga rrjedhat në rajon dhe në Europë. Prandaj, edhe me këtë ligj dëshiroj t'i shoh të rregulluara çështjet e bashkëpunimit, çështjet e përmbushjes së standardeve dhe normave të përcaktuara për vendet anëtare të Bashkimit European.

Ligji për shëndetësinë, ashtu edhe të gjitha ligjet tjera, duhet të jetë i kuptueshëm, i qartë, i harmonizueshëm me sistemin juridik të Kosovës dhe, para se gjithash, i zbatueshëm e në funksion të qytetarit.

Me debatin në këtë Kuvend dhe me debatin nëpër komisione, besoj se ky ligj, në shqyrtimin përfundimtar, do t'i plotësojë të gjitha këto kushte, do t'i shprehë interesat e të gjithë qytetarëve dhe do të përparojë lëminë e shëndetësisë në Kosovë.

Pa pretendime të mëdha, në këtë fjalën time, do të tërheq vërejtjen për disa lëshime që mendoj se janë bërë, dhe me evitimin e tyre ky ligj do të jetë më i qartë, më i efektshëm dhe nuk do të lë mundësinë e dykuptimeve apo mundësinë që me akte ose vendime të tjera të humbet qëllimi themelor i këtij ligji gjatë zbatimit praktik.

Kur flitet për qëllimet e ligjit, thuhet se «Kosova është i vetmi etnitet gjeografik në Europë», e aty duhet «entitet», sepse ky është kuptimi i drejtë i fjalës që duhet thënë në këtë rast.

Te përkufizimet nën a) thuhet se: «qytetari është personi bartës i lejes së qëndrimit të lëshuar nga autoriteti kompetent», e unë konsideroj se qytetari është ë rend të parë banor i përhershëm i Kosovës, e mund të jetë edhe ai që ka leje qëndrimi, nëse i plotëson kushtet për t'u bërë shtetas i Kosovës.

Kur është fjala te terminologjia e përgjithshme, konsideroj se duhet të përfillet nomenklatura e tashme e kodifikuar dhe e pranuar, si ndërkombëtare ashtu edhe e Kosovës, ndërsa çështjet e veçanta edhe mund të rregullohen ndryshe.

Në faqën 5, pika h) kur thuhet: «anëtari i ngushtë i familjes» numërohen «partneri bashkëshortor, prindërit, fëmijët, fëmiju i partnerit bashkëshortor, vëllau, motra, njerka ose njerku» - duhet të hiqet «partneri bashkëshortor» se duket se është një përkthim i keq, nuk e di se nga cila gjuhë, por duhet të thuhet vetëm «bashkëshorti – bashkëshortja» dhe kjo duhet të bëhet më vonë gjithkund në tekst.

Gjithashtu, edhe renditja e anëtarëve të familjes të rregullohet sipas normave të kodifikuara ligjore, pra «bashkëshorti, fëmijët, prindërit» e kështu me radhë.

Në pikën 11.2, në faqën 7, aty ku thuhet se «qytetarët kanë të drejtë dhe detyrim që t'u përmbahen masave të kujdesit shëndetësor dhe të marrin pjesë në zbatimin e tyre» duhet të shtohet se «qytetarët bëjnë edhe krijimin e politikës shëndetësore», si po bëjmë ne në Kuvend por edhe në instanca të tjera. Kjo, më vonë thuhet edhe në nenet e tjera të këtij ligji, sidomos në nenet 20 dhe 21 dhe nenet vijuese deri në nenin 28.

Pra, dua të them se ligji duhet të jetë i harmonizueshëm edhe brenda vetëvetes.

Në kapitullin 3, pika 12.2 Barazia dhe pika 12.5 Gjithpërfshirja, të bëhen bashkë, pasi është i njëjti qëllim dhe e njëjta lëmi.



Gjithashtu, edhe pika 12.6 Sistemi i financimit dhe qëndrueshmëria e tij, të bëhet bashkë me pikën 12.7.

Financimi, kosto, efektiviteti dhe pika 12.8 Bashkëfinancimi, gjithashtu të bëhen bashkë dhe me nënpika të qartësojnë dhe përkufizojnë lëndën.

Neni 14, pika c), ku thuhet se «Kuvendi miraton mjetet financiare për kujdesin shëndetësor», konsideroj se kjo është punë e Qeverisë. E Kuvendi, duke miratuar buxhetin, e bën edhe këtë punë, por jo të veçantë për shëndetësinë. Se, edhe ashtu Kuvendi nuk ndanë dhe nuk ka mjete, por mund të kërkojë nga Qeveria.

Neni 21, propozoj të hiqet apo të riformulohet ndryshe, se aty thuhet «të drejtat dhe detyrimet, sa i përket kujdesit shëndetësor, rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë». Konsideroj se Qeveria nuk duhet të nxjerrë akte nënligjore, por ligje.

Dhe, për mos me bë kritika edhe për nenet tjera, unë jam për atë që ligji sa më saktë të rregullojë të gjitha çështjet dhe të heqë mundësinë që Ministria ose drejtoritë apo institucionet e tjera me nënakte apo, si po thuhet këtu, me nënligje të interpretojnë ligjin në praktikë apo edhe ta ndryshojnë në disa pjesë natyrën e ligjit.

Kam vërejtje thelbësore në nenin 33, sepse nuk mundet «furnizimi, depoimi, shpërndarja dhe dispersimi i barnave të rregullohet me akt të veçantë nënligjor», si thuhet edhe këtu, dhe nuk përcaktohet se kush duhet ta nxjerrë këtë akt.

Pa vazhduar me të gjitha vërejtjet, dua të them se duhet të instalojmë një praktikë - që i themi - të frymës së ligjit që vlejnë për të gjitha ligjet që i aprovon ky Kuvend dhe këtu të jemi të qartë e të mos lëmë shumsinë e interpretimit apo të rregullimit ndryshe me nënakte tjera, se ne, si Kuvend, me rastin e miratimit të ligjit duhet t'i

kemi të qarta të gjitha çështjet dhe t'i dijnë të gjitha pasojat e një ligji.

Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Tani shkojmë me radhë, në emër të grupeve parlamentare. Doktor Fetije Këpuska, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Urdhëroni, doktoreshë.

## FETIJE KËPUSKA:

Ju falemnderit kryetar. Zonja ministre, kolegë deputetë,

Miratimi i ligjit për shëndetësinë e Kosovës padyshim është e një rëndësie tejet e volitshme për popullatën e Kosovës dhe për ardhmërinë e saj. Siç dihet, përkundër shtimit të vëllimit të cilësisë së masave të aktiviteteve dhe të rrjetit të dendur shëndetësor, për ruajtjen dhe avancimin e mbrojtjes shëndetësore të popullatës, shëndeti kudo është më i atakuar sidomos në vendet më pak të zhvilluara, me standarde më të ulët jetësor, me shkallë të lartë të ndotjes së ambientit dhe natyrisht me sistem më pak të zhvilluar shëndetësor. (Më falni, por këtu më pengon kjo dritë).

Objektiv i ligjit duhet të jetë preventimi dhe mbrojtja efikase shëndetësore, trajtim adekuat dhe shërbim cilësor shëndetësor për personat e tarjtuar në të gjitha fazat. Sidomos, duhet sanksionuar mbrojtjen e kategorive të popullatës, të invalidëve të luftës, të punës, familjarët e të të rënëve, të dëshmorëve.

Unë do t'i paraqes disa ide, sygjerime dhe vërejtje në formë të përgjithësuar që do të mund të ishin kontribut modest për shtuarjen, evidentimin dhe përkufizimin edhe të disa aspekteve të cilat në këtë Projekt kanë mbetur paksa jashtë vëmendjes së duhur, jashtë fokusimit apo që janë shtruar në mënyrë të përgjithësuar e që nuk janë zbërthyer, saktësuar e adresuar si duhet.

E them fillimisht se edhe për këtë ligj vlenë definicioni si edhe për të gjitha ligjet tjera – të jetë i shkurtër, i kuptueshëm, i qartë, pa ekuivoqe, të jetë në pajtim me standardet, me praktikat dhe legjislacionin e vendeve më të zhvilluara europndimore, por njëkohësisht të reflektojë, në radhë të parë, rrethanat, mundësitë dhe kërkesat kosovare.

Vërejtjet dhe sygjerimet e mia do t'i shtroj të përgjithësuara nëpër kapituj, pasi që ato konkrete do t'i prezentoj në fazën e dytë, kur do të debatojmë veçanërisht nen për nen.

Në pjesën hyrëse, duhet nënvizuar se ligji rregullon parimet, masat, mënyrën, zbatimin, organizimin e mbrojtjes shëndetësore, bartësit e aktiviteteve.

Institucionet dhe subjektet mbrojtëse shëndetësore - po a shtu duhet saktësuar se çfarë nënkupton mbrojtja shëndetësore, e cila, si e tillë, përmbledhë një kompleks të masave shoqërore dhe individëve të veprimtarive të shërbimeve në ruajtjen, në avancimin e shëndetit, në përkujdesjen shëndetësore dhe rehabilitimin.

Duhet të veçohen në këtë kontekst të drejtat e patjetërsueshme të secilit person në mbrojtje cilësore, adekuate shëndetësore si dhe moscenimin e shëndetit të askujt. Te të drejtat dhe detyrat e personave në realizimin e mbrojtjes shëndetësore, kur bëhet fjalë për barazinë, në tërë procesin – fazat, në të gjitha format e mbrojtjes shëndetësore, duhet numëruar të gjitha të drejtat, madje edhe mundësinë e zgjedhjes me të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me shëndetin e tij, deri te refuzimi i shërimit nga personi jokompetent, të drejtën e refuzimit të pacientit të jetë objekt i eksperimentimit shkencor si dhe një gamë të drejtash të tjera. Natyrisht, duhet numëruar edhe të gjitha detyrimet, në kualitetin e kushtuar kujdesit shëndetësor, parimit gjithpërfshirës, e duhet shtuar dhe atë të vazhdimsisë apo të kontinuitetit.

Ndërkaq, te masat mbrojtëse shëndetësore, duhet paraparë edhe preventimin e sëmundjeve, shërimin dhe rehabilitimin.

Te plani i mbrojtjes shëndetësore duhet shtuar se si duhet të ngërthejë detyrat dhe qëllimet e mbrojtjes shëndetësore, prioritetet si nevojë shëndetësore të popullatës, përgjegjësitë dhe ato specifike si dhe bartësit, detyrat dhe afatet.

Te numërimi i veprimtarive që konsiderohen si kujdes parësor, duhet përfshirë edhe mbrojtjen e gruas, mbrojtjen e fëmijëve të të gjitha moshave, preventivat specifike të disa grupeve të rrezikuara të popullatës, mjekësinë e punës, ndihmën e parë e tjera.

Gjithashtu duhet evidentuar të gjitha veprimtaritë e kujdesit dytësor dhe tretësor shëndetësor, pasi që nuk janë numëruar në të gjitha këto segmente. Lidhur me këtë, pos të gjitha veprimtarive, duhet konstatuar edhe të gjitha institucioneve të cilave u adresohen këto aktivitete shëndetësore.

Te kriteret për përcaktimin e rrjetit themelor të veprimtarisë shëndetësore që përcaktohen me planin e mbrojtjes shëndetësore, duhet patur një konsideratë gjendjen dhe nevojat e tërësishme shëndetësore, numrin, strukturën e popullatës, kushtet, mundësitë ekonomike, objektivat reale aktuale e afatgjate por që ka për synim parësor gjithnjë ofrimin e shërbimeve adekuate cilësore shëndetësore.

Në një kapitull të plotë, jo vetëm me dy pasusa, duhet rregulluar praktikën private, ku do të përfshihen dhe caktohen kushtet që duhet përmbushur personeli shëndetësor që nënkupton kualifikimet përkatëse dhe aftësitë profesionale, hapësirën, pajisjen dhe lejen për punë në ordinancën, laboratoriumin, pastaj shërbimet që mund të ofrojnë si dhe ato që nuk mund t'i zhvillojnë.

Po kështu duhet paraparë edhe mekanizmin e kontrollit të mbikëqyrjes në lëminë shëndetësore, që nga mbikëqyrja e brendshme profesionale, inspektimi, duke



paraparë të gjitha format e mbikëqyrjes. Gjithashtu duhet paraparë taksativat, masat adekuate ndaj rasteve të abuzimeve, mitos, korrupsionit.

Në kapitullin 8, i referohet udhëheqjes dhe mbikëqyrjes në institucionet shëndetësore, duhet të parashihen dhe përcaktohen organet udhëheqëse, mënyra e zgjedhjes së tyre, përbërja e kompetencave, raportet ndërudhëheqëse si dhe raporti në mes këshillit drejtues dhe drejtorit, të caktohen kompetencat, mënyra e vendosjes, pastaj të parashihet vendi dhe roli i këshillit profesional.

Mbi të gjitha, të rrespektohet edhe mendimi i kolegjiemeve dhe bordeve të cilat organizohen në shumë institucione shëndetësore:

Të gjitha këto konkretisht duhet shtruar në fazën kur të debatohet, veçanërisht nën për nen.

Andaj, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne përkrahim në parim këtë ligj.

Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, doktor Sejdullah Hoxha. Urdhëroni, foltorja është e juaja...

#### SEJDULLAH HOXHA:

I nderuari zoti kryetar, e nderuara zonja ministre, të nderuar deputetë,

Sot, para Parlamentit, shqyrtohet Projektligji për shëndetësi të Kosovës me një rëndësi të posaçme për Kosovën dhe popullatën e Kosovës, duke patur parasysh se problemet në sferën e shëndetësisë janë të shumta e të grumbulluara vite të tëra.

Kemi njohuri se Projektligji fillimisht ishte mjaft voluminoz, ndërsa varianti përfundimtar i krahasuar me të mëparshmit është mirë i punuar dhe më i shkurtër që është një përparësi e madhe e këtij Projektligji.

Krahasuar me ligje të mëparshme në sferën e shëndetësisë, mendoj se ky ligj është i hartuar më mirë dhe në procedurat e mëtutjeshme parlamentare, me përmirësime dhe amendamente të duhura do të nxirret një ligj i cili plótëson nevojat e

shëndetësisë kosovare, i cili është harmonizuar me normat dhe standardet tjera ndërkombëtare.

Në vazhdim do të përmend disa vërejtje, të cilat, gjatë procedurave parlamentare, duhet të mirren parasysh në mënyrë që përfundimisht të mund ta kemi një ligj funksional për nevoja afatgjate të përshtatura në kushtet tona dhe të harmonizuara me standarde ndërkombëtare.

Në kapitullin 6 – Organizimi dhe zbatimi i kujdesit shëndetësor, neni 28, lidhur me kujdesin parësor shëndetësor, kur radhiten se çfarë shërbimesh ofrohen, të saktësohet me ligj ofrimi i ndihmave për kujdesin e nënave, ngaqë në maternitetet komunale jashtëspitalore ekzistojnë 16 të tilla.

Një saktësim i tillë duhet të plotësohet edhe në kapitullin 12, neni 74 – Llojet e institucioneve shëndetësore, ishte dashur të figurojë edhe ekzistimi i këtyre materniteteve, natyrisht duke saktësuar edhe numrin e banorëve dhe numrin e lindjeve që duhet kryer këta.

Në nenin 31 të po këtij ligji, kapitulli lidhur me kujdesin tretësor, duhet të saktësohet roli i institutit të mjekësisë ligjore, pasi që funksionimi i tanishim i një instituti paralel në Rahovec nuk i plotëson nevojat e mjekësisë ligjore. Ky duhet të jetë i koordinuar së bashku me ministrinë e drejtësisë, ministrinë e shëndetësisë dhe ministrinë e arsimit. Nga se, për momentin, për shembull një obduksion i zakonshëm duhet të kryhet në të ashtuquajturin institut mjeko-ligjor në Rahovec.

Në po të njëjtin nen, neni 31, mirë do të ishte të figurojë edhe instituti për mbrojtjen e nënave dhe fëmijëve, i domosdoshëm duke patur parasysh mbrojtjen adekuate të kësaj kategorie. Pra, të saktësohet me ligj se duhet të formohet, ngase ligji nuk po hartohet për një përdorim por edhe në ardhmëri duhet të parashihet themelimi i institutit për mbrojtjen e nënës dhe të fëmijëve.

Në kapitullin 12 Dispozitat lidhur me të vdekurin dhe obduksionin, neni 33, duhet më mirë të definohet obduksioni sidomos në nivelin tretësor, pra në qendrën klinike universitare, ngaqë ky institucion kryen veprimtarinë e vet shëndetësore, arsimore dhe shkencore dhe mosdefinimi do të kufizonte veprimtarinë në të cilën ndryshon.

Njëherit obduksionet janë të domosdoshme për caktimin e shkaktarëve të vërtetë të vdekshmëris. Të mirret shembull se sot, për shkak të mungesës së këtij ligji, kryhet një numër shumë i vogël i obduksioneve në institutin patologjik, në dërsa përpara, thuaja se çdo i vdekur i është shtruar obduksionit, tash krejt në mënyrë selektive, mos të them se fare nuk kryhen obduksionet që na shkakton telashe të shumta.

Në nenin 84 të po këtij kapitulli, duhet të saktësohet dhe të plotësohet obduksioni i domosdoshëm. Aty jipet, për shembull, se kur duhet të bëhet, mirëpo obduksioni i domosdoshëm nuk saktësohet saktësisht.

Në po të njëjtin kapitull, veprimtaria e pavarur shëndetësore, neni 96, më duket gabimisht është e formuluar, ose unë nuk e kam kuptuar. Për shembull, aty thuhet: «punëtorët shëndetësor mund të u shtrojnë v eprimtari t ë p avarur s hëndetësore në institucionet nëse janë anëtarë të këshillit të përgjithshëm profesional dhe nëse janë të licencuar për veprimtarinë e caktuar shëndetësore». Për mua është e paqart, ose është bërë ndonjë gabim në formulim, ose thjesht është i paqart.

Edhe në kapitullin 17, neni 112, lidhur me sterilizimin artificial, saktësohet sterilizimi vetëm për femra. Dihet se munden me u sterilizue edhe mashkujt. Kështu që duhet me u saktësua me ligj, sepse siç thash nuk po ndërtohet ligji për një përdorim por për afat më të gjatë.

Ka edhe shumë vërejtje tjera. Mirëpo, megjithkëtë, Grupi Parlamentar i PDK ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe në parim përkrahë këtë me bindje se gjatë punës së komisioneve dhe procedurave parlamentare do të pësojë ndryshime dhe plotësime të domosdoshme duke pasur parasysh rëndësinë e një ligji të tillë.

Nuk e mohoj se për këtë ligj nuk ka patur diskutim publik paraprak, por për këto ligje dhe ligjet tjera me rëndësi të posaçme nuk do të ishte keq që diskutimi publik të jetë më transparent dhe në të të kyçen përfaqësuesit dhe bartësit e institucioneve shëndetësore, përfaqësuesit e shoqatave të mjekve, të cilët janë të shumtë, shoqatat e qytetarëve dhe tjera. Nuk e dij sa janë të popullarizuara, por mendoj se projektligjet me rëndësi të posaçme mirë do të ishte të botohen në mjete të informimit publik, në mënyrë që të sigurohet transparencë e plotë për të gjithë qytetarët dhe të interesuarit. Besoj se kontributi i vërejtjeve të ardhura nga ta, do të ishte i madh.

Ju falemnderit.

### KRYETARI I KUVENDIT:

Doktor, falemnderit. Në emër të Koalicionit «Kthimi» Dragisha Kërstoviq, shef...

(Nga vendi, nuk dëgjohej qart.)



KRYETARI I KUVENDIT:

Më falë, të lutem. Kush është, sepse nuk shkruan në emër të Grupit Parlamentar "Kthimi"? A ka në emër të Grupit Parlamentar, jo deputetë? Nuk ka.

Urdhëro, doktoreshë Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar... Jo, jo, nuk janë marrë vesh ende. Urdhëro të lutem, ju një herit.

(Nga vendi, nuk dëgjohet)

KRYETARI I KUVENDIT:

Nuk është shkruar kërkund – në emër të grupit parlamentar. Mirë, tash po e shikojmë. Urdhëro doktoreshë...

ZYLFIJE HUNDOZI:

Zotni kryetar, zonja ministreshë, kolegë të nderuar,

Shëndetësia kosovare, gjer më sot ka patur shumë vështirësi, dhe në diçka raste edhe lëshime gjatë funksionimit të saj, kështu që hartimi i Projektligjit për shëndetësi ishte mëse i domosdoshëm. Me aplikimin e infrastrukturës ligjore në këtë lëmi kaq të ndieshme për popullatën e Kosovës shpresojmë se do të vjen deri te avancimi i funksionimit në këtë fushë.

Projektligji është i shkurtër qart dhe kuptohet lehtë. Ky Projektligji ka kornizë të mirëfilltë ligjore por është shumë i përgjithësuar, dhe këtë, në njëfarë mënyre hartuesi i Projektligjit e pranon edhe vetë, kur kah fundi i tij thuhet se për zbatimin e tij në praktikë Qeveria duhet të nxjerrë 10 rregullore dhe 38 udhëzime administrative.

Ndoshta ky është një taktizim i hartuesve të këtij Projektligji, të cilët janë frikuar se edhe me këtë Projektligj mund të ndodhë si me Projektligjin për inspektoratin sanitar, ku pas shumë polemikave në Komisionin për shëndetësi, i ndryshohet esenca e këtij ligji dhe qëllimi për të cilin ishte hartuar.

Mirëpo, pa marrë parasysh se cilat kanë qenë qëllimet, Ministrisë së Shëndetësisë i jipen gati të gjitha kompetencat pa u cekë askund transparenca. Askund në këtë dokument nuk ka hapësirë për optimizëm se në shëndetësi do të ndryshohen

kushtet financiare të profesionistëve shëndetësor, që do të ishte një stimulim kyçës për zbatimin e reformave dhe të këtij Projektligji në praktikë.

Veprimtaria shëndetësore primare përshkruhet detajisht, ndërsa sipërfaqësisht përmendet veprimtaria shëndetësore sekundare dhe terciare, por prap premtohet se kjo fushë do të rregullohet me udhëzime administrative.

Nuk përmendet askund raporti mes organizatave joqeveritare, siç është shoqata e mjekve, e cila në praktikë e ka rëndësinë e posaçme.

Shum pozitive është planifikimi i financimit dhe krijimi i fondit për sigurimin shëndetësor, si dhe caktimi i datave konkrete për fillimin e punës të tij dhe të këshillit të përgjithshëm profesional.

Ky ligj është mjaft ambicioz, por nuk është praktik. Megjithatë, ekziston një materie mbi të cilën mund të punohet dhe ne si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrahim miratimin e tij në parim dhe njëherit në komisionin gjegjës do të japim kontributin tonë në përmirësimin e gabimeve.

Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT:

Doktoreshë, ju falemnderit. Unë, për hirë të së vërtetës, po ju them si e ka shkruar: "Samardžić Svetomir, Koalicija «Povratak». Jo në emër të Koalicionit, prandaj unë nuk bëj gabime kurrë. Tani, urdhëroni, pasi që thatë se jeni... Urdhëroni. Jo, s'ka gabime!

#### SVETOMIR SAMARDŽIĆ:

Cenjeno Predsedništvo, dame i gospodo, cenjeni poslanici,

Verovatno da, ja ne znam čemu je smeh povodom mog izlaska. Mislim da je problem nastao u tome što sam ja svoju prijavu napisao ćirilicom. Možda naš predsednik...? Nije, ne znam šta je...

#### KRYETARI I KUVENDIT:

Pritni, ju lutem një moment. Ju lutem, për hirë të të pranishmëve, që nuk janë deputetë...



(Prej vendi: Nema prevoda, nema prevoda!)

... për hirë të mediave, kërkush nuk ka qeshë me deputetin por me fjalën time sepse paraqitja juaj nuk është në emër të Grupit Parlamentar, por vetëm thoni – Grupi parlamentar. Tjetër është grupi, sepse gjithkush e ka, krejt deputetët janë të një grupi parlamentar, por jo në emër të grupit. Prandaj, qeshja ka qenë me mua, e jo me çirlicën, jo me juve si autor, urdhëroni.

### SVETOMIR SAMARDŽIĆ:

Ako je suština u promeni obrasca, u obrascu zbilja stoji ime i prezime, popunio sam i prezime – Koalicija «Povratak» i član grupe za zdravstvo, na koju zaista malo učestvujem.

Medjutim, nije to suština mog izlaska, to su proceduralne stvari oko kojih možemo da pričamo, ali danas pričamo o zakonu o zdravstvenoj zaštiti. Uхватili smo se u koštac da pračamo o jednom veoma složenom i jednom veoma ranjivom sistemu društvene delatnosti. Ovaj sistem je mnogo složeniji i mnogo ranjiviji nego druge delatnosti, kao što su na primer obrazovanje, kao što je pitanje kulture, kao pitanje sporta, jer neke delatnosti se koriste povremeno, ko na primer prosveta, neke se koriste privremeno kao što je kultura ili sport, a zdravstvena delatnost se koristi stalno, neprekidno, počev od svog rođenja kada počinje rođenje u bolnici pa do smrti kada se ponovo život završava u bolnici. U medjuvremenu svako, ili najveći broj stanovnika koristi zdravstvenu zaštitu u raznim oblicima, od porodjaja, kontrole, zaraznih bolesti, vakcinaciji i tako dalje, i radi se o jednom izuzetno, izuzetno važnom..., ovaj jednoj važnoj društvenoj delatnosti.

Medjutim, u kom trenutku mi donosimo ovaj zakon? Kakav je to trenutak društva na Kosovu i metohiji kada treba ovaj zakon da donesemo?

Prvo, u principu, Koalicija «Povratak» je za donošenje sistemskih zakona, je za veoma ozbiljno razmatranje posebno ovih delatnosti. Medjutim, prilikom donošenja ovih zakona – savremena medicinska praksa podrazumeva sagledavanje zdravstvenih potreba stanovništva kome će se pružati takva zdravstvena zaštita. Ovoga puta, prema informacijama koje ja i mam, takva ispitivanja, takva studija nije sprovedena na Kosovu, a sasvim – odgovorno mogu da kazati, u zajednici, u srednima gde živi nealbansko stanovništvo, ili posebno srpsko stanovništvo, nikakav pokušaj snimanja potreba zdravstvenih... potreba stanovništva nije uradjen.

Sa druge strane, jedan dobar, kvalitetan zakon o zdravstvenoj zaštiti, o zdravstvenoj delatnosti može biti rezultat dobrog ekonomskog stanja u jednom društvu dobro razvijenih demokratskih odnosa. Možemo li kazati da se nalazimo u jednom i u drugom? Sigurno ćemo se složiti na ovom polju da nam ni ekonomska moć nije dobra, da ne kažemo od osnovnih zdravstvenih...od osnovnih životnih potreba, da nema čak ni struje, da ne pričamo o drugim, jer zdravstvena delatnost je jako skupa delatnost.

Ovaj zakon, ako bi smo ocenjivali njegove ideje, pre bi se mogao..., nacrt ovog zakona, pre bi smo mogli kazati da je on utopistički, pa će se kazati da će to biti besplatno za sve stanovnike i tako dalje, su utopije koje se neće ostvariti. Da li će to ići na ruku privatnoj lekarskoj praksi koje će zloupotrebiti, i kako koleginica kaže, treba sankcionisati mito i korupciju u zdravstvu. Da li to vodi nečemu drugom, to ćemo tek videti.

Mi smatramo da glad stanovništva, ne samo srpske i nealbanske grupacije, nego čitave albanske grupacije, ja tu imam jako mnogo iskustava radeći na Kosovu, glad za zdravstvenom zaštitom je ogromna. Mi imamo koncentraciju lekara visokostručnih kadrova u Prištini, ali po selima to još uvek ne ide tako, po selima stoji ogromna potreba, pre svega za zdravstvenim prosvetivanjem i za primarnom zdravstvenom zaštitom od koje svi lekari beže. Svi bi hteli da se bave nekom visokom medicinom sa visokom tehnologijom.

Medjutim, ja ću se sada osvrnuti na stanje – šta je sa onom delatnošću, šta je sa onom grupacijom ljudi koja sada, u ovom trenutku, ima nekakvu zdravstvenu zaštitu, mislim na srpske sredine, na sredine gde se zdravstvena zaštita sprovodi na jedan veoma neobičan način. U nekim materijalima, koje ja neću klasifikovati - u koju grupu bi materijala oni mogli da dodju. Govori se o nekim paralelnim strukturama u zdravstvu. Ja vas ubedjujem da se ne radi o paralelnim strukturama. Radi se o egzistenciji... osnovnoj egzistenciji za goli život. Jer vi ne možete kazati da je u vreme kada nesigurnost svih stanovnika na Kosovu velika, da je dostupnost zdravstvene službe ostvarena. To je prvi preduslov za donošenje novog zakona.

Dakle, kada budemo imali prihvatljivost te službe, kada budemo imali dostupnost te službe mi moramo... mi možemo tada govoriti o nekakvoj zdravstvenoj zaštiti u jedinstvenoj teritoriji Kosova i metohije. Daj bože da do tog odnosa dodjemo što pre. U ovom trenutku, mislim da su štetne bilo kakve aluzije na takva... na takva gledanja da se radi o nekakvim paralelnim strukturama, jednostavno moram vam ponoviti, da je zdravstvena zaštita, prosveta, pravnici, znači advokati, lekari i tako dalje, to su grupa koja diže jednu kičmu jednom narodu. Ta kičma mora da ostane. Prema tome, moramo uložiti dodatne napore... Mi ćemo kao Koalicija «Povratak» uzeti veoma aktivno učešće u radu u sagledavanju amandmana koji treba da budu doneti na popravljajući ovog zakona o zdravstvenoj zaštiti, ali preduslovi koji se

moraju za to doneti su neverovatno važni... Zašto? Obzirom da je to jedna društvena delatnost i molim vas da na to gledate sasvim drugačije nego onako kako se to pojavljuje u dnevnoj politici, u dnevnoj štampi i tako dalje, tako da Koalicija «Povratak» ima, još jedan put da vam kažem, pozitivan stav prema zakonu. Uslovi su veoma loši za donošenje ovog zakona, ali ćemo se potruditi da aktivnim svojim učešćem popravimo stanje u ovom zakonu koliko se god to bude moglo i, ukoliko naši interesi ne budu zaštićeni, onda ćemo glasati protiv ovog zakona. Hvala vam.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Faik Marolli, në emër të Grupit parlamentar të grupeve etnike joshqiptare dhe joserbe.

FAIK MAROLLI:

Mjek nuk jam. Nuk do të kritikoj ose nuk do të lavdoj, veç do të përkrahemi.

(Nga vendi: Nema prevod!)

Grupi i të tjerëve etnik, i ashtuquajtur, përkrahë parimisht këtë Projektligj dhe meqenëse ka hapësirë që ky Projektligj do të plotësohet, do të korrigohet në të ardhmen. Duke ditur se ky Projektligj është i rëndësishëm për Kosovën dhe është pru për ne, ne të gjithë e përkrahim dhe thërras deputetët që ta votojnë.

Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit, Faik. I lus përkthyesit që në kohë të bëjnë përkthimin. Ndërsa, deputetët të mos bërtasin, se nuk janë në mal. Kështu që ne do të mundohemi me i kryer punët, prandaj të mos tensionohet atmosfera, ju lutem. Për fjalë është paraqitur Nekibe Kelmendi. Urdhëroni, Nekibe.

Ju lutem, të tjerët, t'i përmbahemi kohës të lejuar me Rregullore, sepse ka shumë të paraqitur dhe dëshirojmë që secili ta marrë fjalën.



NEKIBE KELMENDI:

I nderuari zoti kryetar, e nderuara zonja ministreshë, të nderuar ministra dhe ju deputetë,

Unë nuk do të jam e gjatë, por me dëshirë që të kontribuoj që ky ligj të përmirësohet në procesin e amendamentimit të tij, desha t'i theksoj disa gjëra.

Fillimisht do ta përsëris atë që ka thënë deputetja Nafije Gash, e që i referohet nenit 33. Konsideroj se neni 33 duhet të ketë edhe disa nene pas tij, si: neni për furnizim të jetë nen i veçantë; neni për depojim të jetë i veçantë; shpërndarja dhe dispersimi i barnave nga lista esenciale të jetë gjithashtu i veçantë, në mënyrë që kjo materie të përpunohet më me saktësi sepse edhe çështja e furnizimit me barna, përveç që ka rëndësinë në fushën e shëndetësisë, ka edhe reperkusionet e veta edhe në fushën e financave dhe është pjesa më profitabile e shëndetësisë. Prandaj, duhet të rregullohet në mënyrë që të mos kemi më vonë keqpërdorime apo diçka tjetër.

Duhet të përpunohet shumë më mirë edhe çështja e mënyrës dhe e themeluesit të institucioneve shëndetësore në nenin 40; pastaj te veprimtaria private mendoj se kishte me qenë mirë që koha e ushtrimit të veprimtarisë private e personave që janë të punësuar në shërbimet publike, në veprimtarinë shëndetësore publike, të kufizohet. Është e pamundur dikush tetë orë të punojë në institucionin shëndetësor publik, e pastaj edhe po aq orë të punojë në institucionin e vet privat dhe shtrohet pyetja: sa do të jetë ajo ndihmë kualitative e mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve?

Gjithashtu edhe te neni 98.3, duhet të precizohet dhënia me qira, çka nënkuptohet te dhënia me qira e lokaleve të institucioneve shëndetësore publike? A nënkupton se jepet me qira e tërë hapësira, apo vetëm një shtrat, apo vetëm një dhomë? Prandaj, duhet të precizohet kjo, le të dihet se çka nënkuptohet me atë.

Dhe, në fund, neni 110, ndërprerja e shtatëzënisë për shkaqe të planifikimit të familjes. Më duket aq irituose sa nuk di si ta them! Del se qëllimi i ndërprerjes së shtatëzënisë ka vetëm këtë synim, vetëm planifikimin e familjes! Planifikimi i familjes nuk duhet të lejohet të bëhet përmes abortuseve, sepse ajo e dëmton edhe shëndetin e grave, por planifikimi bëhet me mjete kontraktive, me arsimimin e grave e me shumë instrumente tjera, në mënyra tjera.

Kjo ishte ajo... Dhe, vetëm edhe një moment që mendova ta them – Veprimtaria private në kujdesin shëndetësor, nuk guxon të lejohet që të rregullohet me rregullore të Ministrisë, por ajo duhet të rregullohet me dispozitat e këtij ligji. Sepse, rregullorja është një akt nënligjor, të cilin e nxjerr Ministria përkatëse, kurse ligji – dihet kush e nxjerr ligjin – dhe duhet ta marrim më seriozisht çështjen e veprimtarisë private në kujdesin shëndetësor. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit, Nekibe. Zoti Hasan Meta, le të bëhet gati Muhamet Kelmendi.

HASAN META:

Zoti kryetar, e nderuara Kryesi, zonja ministreshë, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë pajtohem me shumë parafolës, të cilët dhanë disa vërejtje dhe posaçërisht pajtohem me ata që dhanë mendimin se ka qenë kohë e fundit që të kemi një ligj për një veprimtari shumë të rëndësishme shoqërore në Kosovë. Mund të themi, më në fund erdhi. Më në fund erdhi. Dhe, është me të vërtetë shumë e mirë kjo çështje dhe përgëzoj Ministrinë që ka arritur ta përpilojë një ligj i cili përfshinë shumë gjëra në të. Nuk është e lehtë, por prapsepër është bërë.

Mund ta marrim si ligj skelet për funksionimin e një veprimtarie të tërë të mbrojtjes shëndetësore të popullatës, i cili me siguri se së shpejti duhet të mëveshet me nënligje a rregullore të cilat do ta rregullojnë veprimtarinë shëndetësore funksionale për çdo degë, për çdo veprimtari çfarë janë të parapara me ligj.

Përveç atyre që u thanë, unë mendoj se institucionet shëndetësore nuk duhen të kufizohen çfarë janë kufizuar aty, ajo që ekziston tash e tjera, por t'i lehet mundësia që ka edhe tjera ndoshta institucione që duhet të krijohen me kohë, e tjera.

Mendoj se, me përmirësime që do të bëhen nga ekspertë të ndryshëm dhe komisionet, ky ligj do e bën punën e vet në të ardhmen. Dihet mirëfilli se mbështetja ekonomike është faktor kryesor për një shëndetësi moderne dhe shëndetësi efikase. Natyrisht se në këto kushte nuk mund të presim një gjë të tillë së shpejti, por besojmë që – edhe unë të jam pak edhe kësaj radhe të preki pak në politikë – me zgjidhjen e statusit të Kosovës do të rregullohen shumë gjëra, besoj. Sepse, as bashkësia ndërkombëtare, as kërkushi nuk është duke rregulluar çështjen ekonomike në Kosovë.

Dhe, dikujt po i duket qesharake kjo, por është mirë - aty është instituti i mjekësisë së punës, është paraparë – në Kosovë duhet të parashihet edhe një institut i mjekësisë së papunës, për njerëzit që janë të papunë. Dhe, me të vërtetë duhet edhe ajo të mendohet nëse nuk rregullohet diçka tjetër... Dhe, mendoj se kanë të drejtë ata që kur është puna te çështja e punës private në shëndetësi duhet të jetë ligji sa më preciz, ju lutem, sepse ka keqpërdorime. Ju i dini të gjitha dhe besoj se



punëtorët s'hëndetësor më së shumti do t'i gëzohen këtij ligji për s'hëndetësi. Ju falemnderit.

### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shum, edhe për rrespektim të kohës. Muhamet Kelmendi, le të bëhet gati doktoresha Cveta Vujiçiq.

### MUHAMET KELMENDI:

I nderuari zoti kryetar, zonja dhe zotërinj,

Duke marrë këtë Projektligj në shqyrtim dhe lexim të parë dhe duke u mbështetur në atë që po kalon shoqëria kosovare në fushën e shëndetësisë, e në veçanti nga ajo që unë e kam vërejtur për shkak se më ra puna që e kisha nënën shumë të sëmurë dhe në fund më vdiq dhe të jem prezent në klinika e në spitale, e shoh se ky Projektligj nuk ka arritur dy baza kryesore t'i japë që i duhen shoqërisë kosovare.

Një. Nuk është dhënë në mënyrë të qartë, nëpërmes të cilës pastaj do të nxirren ligje tjera të sigurimit shëndetësor falas – nëpërmes kategorizimit të shoqërive dhe shtresave shoqërore. Kur e them këtë, e kam për bazë gjetjen e një mekanizmi juridik dhe ekonomik shoqëror, përmes të cilit do të na dalë një sigurim falas shëndetësor - të atyre që janë në marrëdhënie pune duke paguar një pjesë të veçantë të kontributeve, të atyre që janë të papunë duke i dhënë mundësi që ai të ketë sigurim dhe të gëzojë mbrojtjen shëndetësore falas, të atyre që gëzojnë ndihma sociale gjithashtu, të pensionerëve, invalidëve të punës dhe të luftës, të familjeve e kështu me radhë, dhe duke u pajisur natyrisht me kartela të veçanta nëpërmes të cilit do të ekzistonte një mekanizëm juridik, një institucion i cili do të përkujdesej për këtë çështje. Nëpërmes mospërcaktimit të tillë, dhe natyrisht ky sigurim do të ishte jo vetëm për institucionet publike të sigurimit shëndetësor, por edhe për ato private. Sepse të jeshë prezent vetë në spital dhe të s'hikojsh se si funksionon atje situata dhe pastaj të dalësh të shkos në institucione private, kur e sheh se atje kemi një çmim jashtëzakonisht të lartë e që natyrisht se qytetarët tanë nuk janë mundësi të paguajnë dhe gëzojnë një mbrojtje sikur ata që kanë mjete financiare për të paguar, atëherë ne, me këtë Projektligj, në qoftë se nuk do të rregullojmë në mënyrë të detajizuar kemi bërë pabarazinë e qytetarëve dhe atë diku rreth 80 ose 90% nuk e kanë mbrojtjen e njëjtë shëndetësore sikur e kanë ata që kanë mjete financiare.

Së dyti, që unë mendoj se është shumë e rëndësishme, është jo vetëm përcaktimi se si duhet të funksionojnë institucionet private të shëndetësisë, por edhe kur mund të

hapen ato dhe nga kush mund të hapen ato. Unë ua jap një shembull të Perëndimit. Në qoftë se një doktor shkence i mjekësisë – kirurg i njohur dhe punon në spital, atij nuk i jipet e drejta që të hapë në të njëjtën kohë edhe ambulancë private, sepse dihet mundësia se si do të veprojë ai njeri. Interesi financiar është mbi të gjitha dhe ai të gjithë pacientëve do t'u thonte leni këtu sepse kemi institucione private ku mund të intervenohet, natyrisht shpenzimet do të jenë jashtëzakonisht të mëdha dhe të pamundshme dhe mbrojtja shëndetësore e qytetarëve nuk do të jetë në nivelin e kërkuar dhe që e kërkon.

Prandaj, çfarë duhet të bëjmë? Duhet të përcaktojmë që ky sigurim falas shëndetësor të jetë edhe për institucionet private, sikur që është në Perëndim. Mos t'i lejohet mjekut, mos t'i lejohet ambulancës që ai ose ajo të përcaktojë shumën e parave që duhet të paguhet, që ai të përcaktojë mjetet të cilat duhet të jipen nga qytetarët tanë sepse s'kanë mundësi financiare. Një njeri që ka ndihma sociale 30 euro, apo i një të siguruari pensional që ka 35 euro është e pamundur që të shkojë dhe paguajë atje 20 euro një kontroll pesëminutësh, apo të paguajë një fotografim – një skenim të mushkërive ose ku e diç unë... Prandaj, ne duhet që krejt bazat e tilla të japin këtë ligj dhe përmjet këtij ligji të nxirren ligjet tjera, jo rregullore, por të ligjeve tjera që do të rregullojnë në tërësi fushën e tillë të mbrojtjes shëndetësore, jo vetëm në institucionet shëndetësore publike por edhe në ato private duke u dhënë mundësi qytetarëve tanë të jenë të barabartë në gëzimi në këtyre të mirave shëndetësore, sepse pa këto nuk do të kemi shoqëri të shëndoshë, por do të kemi shoqëri të sëmurë dhe unë ju garantoj se forma aktuale është shumë e rëndë, sepse shtrohesh në spital, detyrohesh të shkosh të bleshë mjetet të cilat duhet t'i jipen pastaj në ndihmë. Shtrohesh në spital, thotë mjeku: s'kam kohë se duhet të shkoj, e tutje. Dhe, natyrisht dakordohem edhe me diskutuesit tjerë kur thanë se një mjek kur punon 8 orë është e pamundur të punojë edhe 8 orë tjera, sepse kualiteti do të bie.

Prandaj, duke i rregulluar këto me ligj dhe duke i vënë në pozita të barabarta dhe duke siguruar sigurimin e tillë falas mbi kategorizimin e shoqërisë, mendoj se do të arrijmë që të gjithë qytetarët të kenë një mbrojtje të barabartë shëndetësore dhe në këtë mënyrë do të arrijmë të kemi edhe një shoqëri të shëndetshme. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Cveta Vujiçiq, le të bëhet gati doktoreshë Teuta Hadri. Ju lutem për rrespektim të kohës, në mënyrë që secili të mund të shprehë mendimin.

## CVETA VUJIČIĆ:

Poštovani predsedniče, poštovano Predsedništvo, kolegenice i kolege, uvažena ministarka,

Meni je zadovoljstvo da mogu danas da raspravljam o jednom veoma važnom zakonu, zakonu koji će imati itekako važnog udela za sve, bez obzira na veru i nacionalnu pripadnost. A ja, kao lekar, dozvolite mi da kažem nešto, pre nego što počnem da komentarišem uopšte zakon koji sam dobila kao i svi poslanici.

Moja duhovna svetinja i opredeljenje je medicinska nauka i edukacija. Razlog za to je želja da se pomogne što većem broje bolesnih ljudi i još većem da se ne razbole. Naš narod kaže – nije važno znanje znati no je važno znanje dati i bolje sprečiti nego lečiti. I ovog puta, moj motiv je da u zdravstvenoj zaštiti pomognem što većem broju naših ljudi da budemo što jači od sudbine. Hoće li ovaj zakon u tome pomoći?

Zakon koji je napisan u 24 poglavlja, 131 član ima i zadire u sve pore zdravstvenog života svih ljudi. Zakon koji su pisali ljudi, uglavnom su to kliničari i zdravstveni radnici drugih profesija a onaj ko bi trebao još da se nadje ovde na spisku, koji bi trebao da učestvuje a to je epidemiolog, i ja ovde ne vidim njegovo ime, a znam jednog vrsnog epidemiologa s kojim smo mi radili, mislim da nije tu.

Kao i moje kolege prethodne koje su komentarisali, i ja imam isto par primedbi na ove članove, pa idem, recimo: član 15. koji kaže «Vlada Kosova preuzima sve mere određene zakonom za obezbeđivanje i izvršenje neophodnih akcija u cilju sprovođenja i zaštite prava građana korisnika zdravstvene nege». Da li bi to trebalo baš Vlada da radi?

Pa, onda idemo član 17. Recimo član 17. tačka j) «U saradnji sa ministarstvom koje reguliše sektor za poljoprivredu, šumarstvo i pruralni razvoj nadgleda kontrolu kvaliteta usluga hrane i drugih poljoprivrednih proizvoda radi zaštite potrošača». Mislim da je ta tačka nadjena u Zakonu o sanitarnoj inspekciji i mislim da bi joj tamo bilo mesto i dalje.

Ono što mene posebno ovako ovde zabrinjava, kao i kolegenicu Nekibe, a to je ono što se odnosi na prekid trudnoće. Prekid trudnoće koji je itekako bitan, normalno oza one koji žele da prekinu trudnoću, ili u smislu planiranja porodice, ili pak one koje to ne žele iz niz razloga, ali ima jedan član tamo, tačno član 110, 102. i 103. koji se odnosi na to da bi se prekid trudnoće mogao obaviti samo u saglasnost sa socijalnim radnikom, ginekolozima, akušerima i psihologom. Član isti, koji govori o prekidu trudnoće u Zakonu pravnoopravnosti polova apsolutno doslovce, koliko se sećam, je isti, samo što navodi još jednu stavku a to je da prekid trudnoće mogu



uĉiniti i maloletnice do 18 godina a onda opet se isti ljudi pitaju i odluĉuju o prekidu trudnoće. Mislim da ovde neŝto nije u redu i da treba jedan i drugi zakon uskladiti, odnosno te taĉke u okviru tog zakona o prekidu trudnoće, pa opet to poglavlje govori da će se doneti poseban zakon o prekidu trudnoće. Da li je potrebno donositi, samo kada su dve-tri taĉke u pitanju poseban zakon o prekidu trudnoće?

Ono ŝto bih napomenula joŝ, a to je kliniĉko istraŝivanje ljudima, posebno poglavlje – poglavlje 17 i onda ono govori ponovo – treba ponovo pisati neki novi zakon. Kliniĉko istraŝivanje u medicini a i u opŝte drugim granama i istraŝivanje uopŝte vezano je za zakon koji govori o nauci, za nauku i tehnologiju. Prema tome, sve ŝto se planira u okviru toga, nauĉno istraŝivanje apsolutno ide preko ovog zakona pa i kliniĉko istraŝivanje, onako mislim da tamo moŝe da se uskladi a ne ponovo neki novi zakon. Mislim zakonodavci moraju o tome malo da povedu raĉuna.

A mene, kao kliniĉara, opet doktora koji je upoznat i sa primarnom sekundarnom i terciarnom zdravstvenom zaŝtitom, posebno je zabrinuo jedan drugi ĉlan - ĉlan 31. ovog Nacrta zakona. I on sada govori o terciarnoj zaŝtiti a ta terciarna zaŝtita obuhvata institucije koje su sada novoformirane. To je Univerzitetski kliniĉki centar, Nacionalni institut za transfuziju krvi i tako redom. Da li sa formiranjem novih ovih institucija – Univerzitetsko-kliniĉkog centra, Nacionalnog instituta za transfuziju krvi, i niz joŝ, ne gasi li se moŝda i institucija odnosno i institucije u kojima smo mi do 99. godine radili, gde su Srbi radili i imali 4 hiljade radnika. Gde sada..., ne li se njima sada uskraćuje mesto povratka. Mislim da o ovome treba da razgovaramo i razmiŝljamo. Ovako, ne bih mogli kako je formulisano. Hvala.

#### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Teutë Hadri, le të bëhet gati Smajl Latifi.

#### TEUTË HADRI:

Të nderuar deputetë, i nderuar zoti kryetar, e nderuara zonja ministreshë,

Ligji për shëndetësinë e Kosovës mendoj se është një ndër ligjet e veçanta në Kosovë që deri më tani ka gjetë një përkrahje demokratike dhe është përdorur gjatë përpunimit të tij në mënyrë publike nga qytetarët e Kosovës. Edhe sot, para se të dalim në këtë Parlament, për ta miratuar këtë ligj, ligji i shëndetësisë është përgatitur dy herë për të dalur në miratim dhe ajo çkë është më e rëndësishme, siç thash, është i vetmi ligj se në këtë ligj kanë marrë pjesë publiku i Kosovës, kanë

marrë pjesë, të gjithë besoj e dijmë, drejtorët e klinikave të Prishtinës, derjtorët e spitaleve, drejtorët e shtëpive të shëndetit, drejtorët e drejtorave të komunave për shëndetësi dhe ekspertë nga lëmia e shëndetësisë, të cilët kanë dhënë kontributin e vet që edhe ne sot të dalim me këtë ligj. Por unë shpresoj se sot parimisht ky Parlament do ta bëjë miratimin e këtij ligji. Prandaj, si deputete e këtij Parlamenti, ndiej një obligim që me vërejtjet e mia t'i bashkëngjitem dhe të kontribuoj që ky ligj të jetë sa më i efektshëm dhe funksional.

Kam vërejtje te përkufizimet, te neni 1 – veprimtari shëndetësore, ku është cekë “shërbime obstetrike”. Këtu mendoj se është i cunguar funksioni i një shërbimi dhe është keqpërdorur se shërbimi obstetrik, pikërisht shumimi dhe sterilizimi i përkasin gjinekologjisë dhe duhet të jetë shërbim gjinekologjik por do të jetë edhe obstetrik, pikërisht sterilizimi i përket gjinekologjisë. Prandaj duhet të jetë “shërbime gjinekologjike”, parimisht.

Vërejtjen e dytë e tha edhe doktor Sejda, te çështja e sterilizimit, nuk kam nevojë të komentoj.

Te neni 8 dhe 4, mendoj edhe juristët pajtohen, është një nen që 8-shi është shumë i shkurtër dhe është si në vazhdimësi.

Mendoj se neni 9 i bashkëngjitet nenit 8.

Te parimet e kujdesit shëndetësor, neni 12. Këtu edhe zonja Nafije Gash, pajtohem plotësisht se ka termin e shqiptimit “gjithpërfshirje” e kanë keqpërdorur dhe në vend që të thuhet “përfshirje e të gjitha shtresave të shoqërisë” këtu ia kanë përzier me barazinë dhe të drejtave të qytetarëve, prandaj plotësisht pajtohem.

Dhe, te kapitulli 5 – Kujdesi shëndetësor. Këtu është shumë e rëndësishme, sepse janë cekur të gjitha kategoritë e njerëzve që mund të kontribuojnë për shërbime shëndetësore, por kategoria e shtatëzënës, që janë në pyetje dy jetëra – jeta e nënës dhe e gruas mungon në këtë shërbimin shëndetësor, çka është e mangët, prandaj duhet parimisht menjëherë të plotësohet.

Te kujdesi parësor shëndetësor, edhe këtu, neni 28 janë futur në komuna të gjitha shërbimet, ndërsa gjinekologjia, ku mendoj se mbi 50% të popullatës të numrit të pacientëve janë nga aspekti gjinekologjik dhe fare nuk caktohet si shërbim që bëhet nëpër institucionet, që do të thotë bëhet në institucionet tona.

Dhe, si përfundim, kujdesi tretësor shëndetësor, mendoj se të gjitha institucionet dhe qendrat janë përmendur, mirëpo s’di pse s’është përmend edhe Instituti i Mjekësisë së Punës në Kastrriot, që është një institut që vepron me kohë të gjatë dhe ka një numër aq të madh si të punëtorëve shëndetësor, mjekëve e specialistëve.

Nuk e di si nuk është futur në këtë shërbim, kur dihet se është një institut me një numër shumë të madh të punëtorëve.

Dhe, para se t'ju falënderoj për fjalën që më dhatë, desha t'i përgjigjem kolegut nga "Povrataku" që le t'i ndalojnë këto mashtrimet që mundohen t'i bëjnë para popullatës se sistemi paralel, edhe i shëndetësisë, vepron në Kosovë. Dhe, për ta dëshmuar këtë, ndoshta ju nuk e keni dijt dhe unë do t'ua përmendi një rast që në Klinikën tonë gjinekologjike e kanë sjellur pacienten për të vdekur fëmija ... Dhe ajo çka ka bërë klinika jonë për ndihmën e kësaj nëne dhe të këtij fëmiju, kanë ardhur edhe mjetet e informimit të KFOR-it për ta përkrahur dhe për ta informuar popullatën se me të vërtetë në institucionet tona shëndetësore punohet shumë drejt edhe për pakicat. Por, unë këtu desha të them se është popullata apo udhëheqësit e saj serb që e dezorientojnë popullin e vet. Ata kanë ardhur, e kanë marrë pacienten me dhunë, e kanë tërhequr nga klinika jonë dhe e kanë çue në shërbimet paralele serbe në Mitrovicë, vetëm për ta humbur mundin e popullit kosovar që punon për t'i ndihmuar edhe minoritetet. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT:

Doktoreshë, ju falemnderit. Smajl Latifi, le të bëhe gati doktoresha Rada Trajković.

#### SMAJL LATIFI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra,

Gjendja në shëndetësi është e rëndë dhe si e tillë ajo duhet gjithnjë të ndryshohet në të mirë sepse është në interes të mbrojtjes së shëndetit të popullit të Kosovës. Roli i mjekësisë dhe i institucioneve shëndetësore për mbrojtjen e shëndetit është shumë i madh. Janë inkurajuese përpjekjet e të gjithë atyre mjekëve që edhe përkundër vështirësive të natyrës ekonomike financiare po bëjnë ç'është e mundur për të ushtruar profesionin denjësisht të mjekut, kryesisht kryerjen e obligimeve ndaj njerëzve pra pacientëve.

Janë tejet shqetësuese edhe dobësitë, neglizhencat dhe sjelljet jo të mira që evidentohen sot nëpër institucione të ndryshme mjekësore. Janë edhe më shqetësuese, pra si anë negative, dukuria e formave të ndryshme të korrupsionit, mitos që jo rrallë bëhen edhe burim i së keqës për pacient të ndryshëm të cilët i rrah varfëria dhe m'u për këtë edhe e pësojnë. Kur flasim për shëndetësinë, ngrotjen dhe forcimin, organizimin sa më të mirë të shërbimeve shëndetësore,



duhet të kemi parasysh edhe këto shqetësime që janë probleme po ashtu shqetësuese për popullatën.

Do të kisha pyetur, pse nga Ministria e shëndetësisë, për shembull, të bëhet administrimi i rezervave shtetërore të barnave, ose medikamenteve në kushte të katastrofave të natyrës apo të atyre që i shkakton faktori njeri? Dhe, në këtë rast, cili do të ishte pozicioni dhe funksioni i Trupave të Mbrojtjes së Kosovës në të tilla situata kur e dijmë të gjithë se ky mekanizëm apo institucion e ka përgjegjësinë dhe mandatin për veprime emergjente. Në situata të tilla çdokund rezervat shtetërore të barnave administrohen nga ushtria. Në rastin tonë, TMK duhet ta ketë këtë të drejtë sepse ajo do të përballet drejtpërdrejt me nevojat dhe kërkesat që i shtrijnë situatat emergjente si vërshimet, terrmetet, zjarret, lufta e tjerë.

Një pyetje tjetër, gjithashtu që është me interes të kërkojmë përgjigje është: A ka institucione në Kosovë që merren me testimin dhe ekzaminimin e prodhimeve farmaceutike të shteteve të cilat nuk i përmbahen procedurave prodhuese sipas standardeve evropiane? Dihet cilat barna e mbulojnë aktualisht shumicën e tregut ë Kosovë. Nëse ka të tilla institucione apo laboratore që i çertifikojnë prodhimet e testuara, cilat janë ato, është mirë që ta dijmë.

Do të ishte e dëmshme që të pretendohet të vendoset sistemi i monopolit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë tek institucionet përkatëse mjekësore. Çdo pretendim për të vendosur monopol e kufizon dukshëm hapësirën për partneritet.

Një pyetje tjetër, gjithashtu është me rëndësi: Si është paraparë administrimi i qendrave rehabilituese në Pejë e Kllokot qendra të cilat bien në kompetencat e shërbimit mjekësor tretësor, pra që duhet të kalojnë në kuadër të QKU dhe përmjet saj në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë? Këto dy qendra – përse nuk kalojnë në kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë? Pra, dy qendrat në fjalë, nuk duhet të mbesin edhe më tutje pre e interesave materiale të grupeve të ndryshme por duhet të kalojnë urgjentisht në duart e Ministrisë së Shëndetësisë.

Ne besojmë e ky Projektligj do ta ketë parasysh edhe një trajtim – rregullimin e një trajtimi të kujdesshëm dhe falas për pacientët që vijnë nga familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës e të punës, veteranëve e të familjeve që kanë pësuar dhe janë goditur nga okupatori gjatë luftës çlirimtare. Kosova pas luftës ka nevojë shumë për një organizim më të mirë, funksionim dhe efikasitet më të mirë të të gjitha institucioneve mjekësore dhe rregullimin sa më të mirë me ligj të veprimtarisë së përgjithshme shëndetësore në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoja Trajković, le të bëhet gati Nurishahe Hulaj. Për politikë, mosni ju lutem dhe lereni politikën. Ligjin tani e kemi. Me emër nuk ju ka përmendur. A ju ka përmendur me emër dikend? Përkthimi le të funksionojë. Në qoftë se s'ju ka përmendur me emër, mos lypni fjalën, ju lutem. Ju lutem, përkthimi le të funksionojë me kohë.

SVETOMIR SAMARDŽIĆ:

Drage kolege, ja nisam hteo da nešto posebno da zaoštravamo naše odnose i uopšte nema potreba za to. Medjutim, kolegica koja je htela da mi ukaže na slučaj žene koja se lečila na Ginekološkoj klinici je u stvari jedno simpatično i dobro pravilo, i mislim da smo mi učili istu školu. I hvala bogu da smo Hipokratovu zakletvu isto izgleda izučili i taj slučaj potvrđuje samo pravilo, taj izuzetak potvrđuje pravilo da je neko ko je zabrinut za zdravlje te žene došlo, i što ona kaže, prisilno odveo tu ženu u druge institucije. Upravo to govori o ranjivosti sistema. Nemam uopšte sklonost da kažem da su lekari Ginekološke klinike loše postupili. Izvanredno mogu zahvaliti na takvom jednom odnosu. Medjutim, jedna analogija. U vreme, koje ne želimo da se sećamo više tog vremena, bila je propaganda, odnosno tvrdilo se, stručnjaci su tvrdili da žene Albanke ne žele svoju decu da dovedu na vakcinaciju, to je slučaj obrnuti. I tada smo govorili, niko ne može voleti svoje dete kao njegova majka, bila ona ove ili one nacionalnosti. Dakle, mi ovim zakonom, njegovim preduslovom za stvaranje tog zakona, moramo isključiti mogućnost da neko nama prisilno dovodi decu ili da tvrdimo da neko voli bilo ko, pa makar bio on predsednik koje države voli dete više nego njegova majka koja ga rodila. Dakle, kolegicu podržavam, replika je u smislu podrške, ali izuzetak potvrđuje pravilo da moramo raditi na eliminaciju takvih stanja. Hvala vam.

KRYETARI I KUVENDIT:

Le të bëhet gati Nurishahe Hulaj.

RADA TRAJKOVIĆ:

Poštovana gospodo, dugo nisam bila u ovom Parlamentu, prosto zato što sam mislila da niti je Parlament mesto gde možemo, na sasvim dobar način da ostvarimo prava za sve zajednice, jer do dana današnjeg gotovo nijedan projekat koji je bio od interesa za sve ljude koji žive na prostoru Kosova i metohije nažalost

nije bio ostvaren. Znači, svi projekti radjeni su samo za jednu zajednicu i samo za jedan narod.

I sada sam došla upravo da vam kažem, da kada čitate zakone koji se donose, svakako pomislite da se radi o nekom području gde su uslovi života sasvim normalni, o nekom području gde nema ovako drastično kršenje ljudskih prava kao što je prostor Kosova i metohije i kao što je kršenje ljudskih prava Srpske zajednice.

Kada govorimo o Srbima, onda moramo da govorimo i o jednoj realnosti koja je u stvari... način života na ovom prostoru je život paralelni. Jedne zajednice, koja ima sve, i jedne zajednice koja...

(Ndërprerje në ton)

... Iz realnosti života koji proistiće sa terena, ja isto tako želim da vam kažem da zakone koje pišete nisu u mogućnosti da budu implementirani upravo zato što vi niste spremni ili albanska većina nije spremna da implementira. Četiri hiljade Srba je bilo u Kliničkom centru Prištine. Danas je to veleepna zgrada, institucija, gledam je sa strane i ako sam 20 godina u njoj radila, već peta godina u njoj se ne radja nijedna srpska beba, već peta godina u njoj se ne leče srbi pacijenti, već peta godina mi živimo u segregaciji, u kršenju ljudskih prava i samim tim opravdanje postojanja srpskih institucija je realnost i naše je opredeljenje da zdravstvo koje je dostupno srpskoj zajednici bude u sistemu države Srbije.

Možda ćete se ljutiti, možda ćete izražavati kao što izražavate svoje proteste, ali ja želim, vrlo iskreno da vam kažem: sve do momenta, dok se ne ostvare ljudska prava u smislu dostupnosti institucija, sve do momenta dok se ne ostvare naša prava u smislu povratka Srba u institucije u koje su nekada zajedno sa vama radili – svi ovi zakoni koji budu usvajani u ovom Parlamentu neće biti obavezujući za srpsku zajednicu.

Zajednica, koja nema prava, ona nema ni obaveze. S tim u vezi, ja želim vrlo iskreno da vam kažem, ma koliko se vi ljutili. Meni verujte, ja već... Meni je prosto interesantno kada se ljutite! I ne bi bilo dobro kada bi me gledali i odobravali! Sve dok ne budete videli realnost vašu na terenu...

(Ndërprerje në ton)



## KRYETARI I KUVENDIT:

Ju ka kaluar edhe koha... dhe jashtë temës është duke biseduar.

Unë e ndiej një obligim moral ndaj Parlamentit dhe qytetarëve që po na përjcellin. Me sjellje të këtilla të deputetëve, jo që nuk zgjidhen problemet, por krijohen. Ka shumë kohë më parë kur institucionalisht shumë prej nesh i kemi thënë çdo qytetari të Kosovës të paraqitet në konkurse. Bile zojës Trajkoviq, sa ka qenë shefe e grupit parlamentar, asaj i kujtohet, ndoshta e ka pasë për hajgare si gjithmonë, ajo mua më është kërcnuar se do t'më ndërroj prej kryetarit. I kam thënë, eja dhe punësou në vendin e punës, paraqitu. Dhe ky parim vlenë për të gjithë kosovarët. Prandaj, në qoftë se dojmë me i kontribuar shëndetësisë, unë për atë thash doktoresha Rada Trajkoviq. Prita që ajo do të jepë ndonjë kontribut vërtetë për përmirësim të ligjit e jo për çështje të këtilla.

Prandaj, të vazhdojmë Nurishahe Hulaj, le të bëhet gati Mehdi Bardhi.

## NURISHAHE HULAJ:

Vetë procedura e paraqitjes së ligjit sot në Parlamentin e Kosovës është vonuar shumë, prandaj është vonuar edhe mbrojtja shëndetësore e popullit të Kosovës. Mirëqenia e plotë fizike, psiqike dhe sociale paraqet shëndet. Për të patur shëndet, duhet të kemi edhe një zhvillim ekonomik më të avancuar, sepse gjithmonë janë nën një interaksion. Me ligj Kosova ka nevojë për një reformë substanciale, me identifikim të nevojave shëndetësore, me politikë strategjike zhvillimore të planifikuar dhe programuar në reforma të saja operative, afatmesme dhe afatgjata të mbrojtjes shëndetësore, duke përfshirë kujdesin shëndetësor, organizimin, strukturimin dhe definimet shëndetësore, resurset humane, resurset e shërbimeve shëndetësore dhe resurset financiare. Por, gjithherë për për realizimin e reformave shëndetësore duhet të kemi parasysh treguesit e statistikës vitale të popullit të Kosovës me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, të kostos së efektivitetit financiar dhe orientimit të zhvillimit shëndetësor. Ne mund të ilustrojmë tregues të statistikës vitale dhe mendoj se janë shumë të rëndësishëm për Kosovën dhe mbrojtjen shëndetësore të saj. Dhe këta tregues tregojnë se Kosova ka rreth 10.908 kilometra katror, me 2 milion e 105.000 banorë, me dendësi 192 banorë në një kilometër katror që do të thotë është një dendësi e lartë e popullit të Kosovës, 40.3% të popullsisë janë fëmijë 0,14 vjeç, më shumë se gjysma e popullit janë të moshës nën 25 vjeç, 8% të banorëve janë mbi moshën 60 vjeçare, kurse 22.4% janë femra të moshës fertile 15 deri 49 vjeç. Koefficienti i natalitetit është 22.3 promil, koefficienti gjegjësisht shkalla e mortalitetit infantil për fëmijët 0,12 vjeç është 35 promil. Këto janë të dhëna të evidentuara por mund të ketë edhe të

dhëna të tjera të paevidentuara që duhet t'i identifikojmë me anën e ligjit. Prandaj, është një indikator që e matë edhe zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

Në bazë të këtyre treguesve dhe analizës shëndetësore, ne mund të orientojmë zhvillimet politike shëndetësore në Kosovë, me prioritet të veçantë të mbrojtjes shëndetësore të nënës dhe fëmiut sepse janë grupacione më vullnarabile, gjegjësisht të n dëshme të p opullatës së Kosovës. Në baza ligjore për mbrojtjen shëndetësore të nënës dhe fëmiut kërkojmë qëllimin e harmonizimit të standardeve dhe normativave të shërbimeve shëndetësore në kuadër të kujdesit parësor, dytësor dhe tretësor për nënat dhe fëmiun. Kjo nuk është transparente në nenin 22.2 që do të ketë vështirë edhe Komisioni shëndetësor për amendamentimin e këtij neni.

Një prej qëllimeve të politikës shëndetësore është fillimi i shëndetshëm i jetës që ka për qëllim të zvogëlojë morbiditetin, mortalitetin maternal dhe infarntid, përmirësimin dhe përparimin e shëndetit riprodhues si dhe të fëmijëve. Konsiderohet se morbiditeti dhe mortaliteti infarntid gjegjësisht foshnjat 0,12 muaj paraqesin një prej problemeve socialo-mjekësore më serioze dhe më të ndërlikuar tek ne. Gjertani është punuar përmes udhërrëfyesve të ndryshme, rregulloreve për shëndetin p a harmonizim të standardeve dhe normativave të ndryshme. Në këtë drejtim kanë kontribuar edhe organizatat ndërkombëtare qeveritare në Kosovë dhe kanë avancuar në një masë çështjen shëndetësore.

Me ligjin për shëndetësi mund të sigurojmë standarde të kujdesit shëndetësor përmes promovimit të cilësisë dhe rregullativave të të gjitha institucioneve dhe autoriteteve shëndetësore në Kosovë. Gjthashtu mund të sigurojmë udhëheqje dhe koordinim të aktiviteteve shëndetësore duke përfshirë p articipimin e komunitetit dhe zhvillimit të inisiativave të komunitetit për një qasje multidisiplinare në realizimin e të drejtave të tyre të shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore pa dallim feje, gjinie, race, nacionaliteti e të tjera.

Ligji mundëson tri nivele të mbrojtjes shëndetësore, atë parësor, dytësor dhe tretësor. Edhe në politikën shëndetësore përcaktohet prevenca primare, gjegjësisht mjekësia familjare ku do të përfshihen 80 deri 90% e popullatës, që në fillim të vitit 2000 qendrat e mjekësisë familjare kanë qenë të zbrazura për arsye se janë dhënë specializime pa kurrfarë kritere dhe është bërë grumbullimi i kuadrit nëpër zonat urbane, kurse zonat rurale kanë ngelur pa mjek. Në të tri nivelet nuk janë paraqitur normativat dhe standardet shëndetësore dhe vështirë e kemi për të bërë amendamentimin dhe në shum vende është cekë se do të rregullohet me akte nënligjore.



KRYETARI I KUVENDIT:

A po e përfundoni, sepse ju ka kaluar koha, ju lutem. Rrumbullakësojeni...

NURISHAHE HULAJ:

Vetëm edhe një segment dua të ceku këtu. Sigurimi i fondeve shëndetësore, në ligj është paraqitur që më 1 janar të vitit 2005 do të startojmë me sigurimin e fondeve shëndetësore. Mendoj se është shumë e vonuar kjo dhe ndikon në mënyrë indirekte në mbrojtjen shëndetësore të popullatës.

Neni 92.4 për specializimet, edhe kjo është e padefinuar dhe e paqartë që kërkon transparencë.

Një segment tjetër të rëndësishëm, që mendoj është një tregues i rëndësishëm, sistemi informativ shëndetësor. Struktura e shërbimeve shëndetësore është ende e padefinuar. Kemi fragmentarizëm të informatave, gjë që reflektohet edhe me relevancën e interpretimeve sepse ka munguar infrastruktura ligjore e në anën tjetër, sistemi paralel i evidentimit, grumbullimit të të dhënave, mungesa e rrespektimit të domosdoshëm për të raportuar. Kjo dukuri vërehet në disa pjesë të Kosovës, në Mitrovicën veriore, Leposaviq, Zubin Potok e të tjera.

Edhe përkundër rezultateve të arritura në parandalimin e sëmundjeve ngjitëse, Kosova ende ngelet problem dominant nga sëmundjet ngjitëse, sidomos të fëmijët e vegjël dhe ata parashkollor, që 52% janë udhëheqëse sëmundjet ngjitëse dhe parazitare, prandaj kërkohet një ligj i veçantë në këtë drejtim.

Dhe, në fund, konsiderojmë se mbrojtja shëndetësore në ligj paraqet domosdoshmërinë e rrespektimit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, të evidentimit, përpunimit të të dhënave, analizës dhe publikimit të tyre dhe informimi i ndërsjelltë në tërë sistemin informativ në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Mehdi Bardhi, le të bëhet gati Rangjell Nojkiq. Ju lutem të rrespektohet koha. Ju lutem, janë edhe dy diskutues, pak kujdes, ose po bëjmë pauzë.



MEHDI BARDHI:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kuvendarë,

Unë, pasi që sot bisedojmë për Projektligjin për shëndetësinë dhe dihet se sot nuk bisedojmë nen për nen, por ndoshta shkurazi do të përmendet edhe ndonjë nen i këtij ligji. Por unë do t'i them disa gjëra, për shembull, të cilat pak do t'i prek, ca deformime, ca deformime që në shoqëri dhe në mjekësi, të cilat konsideroj se inspeksioni shëndetësor nuk do të mund t'i mënjanojë.

Tani me një ritëm paksa të ngadalësuar por do të thosha të sigurt po ecim drejt shtetit së drejtës, duke krijuar infrastrukturën ligjore juridike, konform standardeve evropere.

Para nesh sot kemi Projektligjin mbi shëndetësinë, ligj ky shumë i rëndësishëm dhe i dobishëm për shëndetin e popullit. Si duket, ligji mbi shëndetësinë i mungon vetëm Kosovës.

Me legalizimin e ordinancave dhe spitaleve private, farmacive, licencë e palicencë, është krijuar një konkurrencë jolojale në shërbim ndaj pacientëve, ku ka edhe diskriminim sidomos në spitalet shtetërore. Disa mjek, jo të gjithë, punojnë në spitale shtetërore vetëm për të kontaktuar shërbime mjekësore për ordinancat e veta private. Pacienti në spitalin shtetëror, në qoftë se don t'i shtrohet operacionit menjëherë – heqja e gurëve në ithzë duhet të paguajë 400 euro, do të thotë 200 më pak se në ato private, këto 400 euro mjeku i ndanë me motrat, të cilat do t'i rrinë te koka pacientit që ka paguar paratë. Ky mjek është i njëjti kirurg si në spitalin shtetëror, si në ordinancën private. Ai që ka para mund të zgjedhë, edhe në spitalin shtetëror ose në atë privat pa pagesë. Shtrohet pyetja – çka do të bëjë ajo kategori sociale, e cila nuk është e vogël, e cila nuk ka mundësi të paguajë e lëre më të zgjedhë spitalin shtetëror apo atë privat. Për këtë grup skamtarësh mjekët e spitaleve shtetërore e hartojnë një listë të radhës së shtrimit apo operacionit në spitalin shtetëror. Skamnari vjen në rend pasi të harxhohen ata që kanë paguar apo që kanë korruptuar mjekun dhe të presin një, dy, tre muaj radhën për operacion, në qoftë se nuk vdes. A është ky diskriminim? E unë do të thosha – edhe vepër penale. A janë shkelur ligjet e Hipokratit – etika mjekësore? Tani këto nuk janë raste, por janë bërë dukuri. Kemi raste kur pacienti për shkak të pakujdesisë së mjekëve, disa pacientë e kanë humbur edhe jetën. Familjarët e viktimës janë njoftuar me një njoftim se i afërmi i tyre ka vdekur, pa kërkuar shkakun.

Në bazë të këtij ligji, neni 121, pika 3 dhe neni 122, parasheh masa ndëshkuese dhe fillimin e procedurave nga personi juridik dhe ai fizik, ku deri më tani nuk është ngritur asnjë padi në gjykatat tona.

Për një qasje të barabartë, pa diskriminim ndaj pacientëve, propozoj një amendament të ri në këtë ligj. Mjeku i cili ka kryer specializimin në spitalet shtetërore në Kosovë apo jashtë dhe ka themeluar marrëdhënie të punës në spitalin shtetëror ka paguar edhe stazhin pensional, mund të punojë në një apo dy spitale shtetërore. Mjekët që punojnë në ordinancat apo spitalet private, kanë të drejtë të punojnë në një apo më shumë ordinanca spitalore private. Mjekët që punojnë në spitalet shtetërore, të parashtruar në alinenë 1 të këtij neni, nuk mund të punojnë në institucione shëndetësore të spitaleve shtetërore dhe plus në ato private. Ky nen do të jetë në favor të qasjes së barabartë të shërbimeve mjekësore ndaj qytetarëve dhe kategorive sociale. Ky nen do të mënjanojë anomali të krijuara në shëndetësinë e Kosovës.

Projektligjin e përkrahu në parim, me shpresë se do të plotësohet aty ku ka të meta. Ju falemnderit.

### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Rangjell Nojkiq dhe le të bëhet gati Blerim Baruti, i fundit.

### RANDJEL NOJKIĆ:

Dame i gospodo, Radno predsedništvo,

I ovoga puta, kao i mnogo puta do sada, pošto je gospodin Daci dosledan u svojim nastojanjima, on vrši apsolutnu diskriminaciju. Ja sam se javio, to zna sekretarijat, pre nego što je počela sednica. Posle mene su se svi govornici koji su govorili ispred Koalicije «Povratak» i mnogi drugi javili, ali je on stavio mene na kraju, verovatno zato što je navika njegova takva, zato što on tako misli da treba da radi i on dalje radi. I to je zapravo problem svih problema, i to je problem zbog čega se u ovoj Skupštinskoj sali u Skupštini Kosova i metohije izražena veoma, veoma velika polarizacija povodom usvajanja zakona. Pitam vas samo – kako će se gledati na zakone koji se usvajaju ovde po nacionalnoj osnovi? A to jeste praksa. Ovo treba da zabrine ne samo ovo skupštinsko zdanje već i međunarodnu zajednicu koja je veoma odgovorna za ovakvo stanje u ovim institucijama.

SPGS je do sada doneo mnoge zakone, usvojio, zapravo potpisao mnoge zakone, ali će u sprovođenju da se upravo pokaže njihova ispravnost i njegovo ispravnost odnosno njihova ispravnost koji su potpisali takve zakone, iako se u mnogim slučajevima nije poštovala ni procedura.

Ja nisam stručnjak iz ove oblasti a dao sam sebi za pravo da kao poslanik dam doprinos u smislu da se zakoni donose prema prostoru, prema mentalitetu, prema problemima koje jedno područje opterećuje. I mislim da bi isto tako trebali zakoni da se donose i za ovo područje, za područje Kosova i metohije. Nažalost, ne donose se takvi zakoni i primer koji je kolegenica malopre iznela iz bolnice u Prištini, ako sam dobro shvatio, ukazuje na jednu drugu činjenicu, na činjenicu da Srbi nisu sigurni u tim institucijama. To najbolje govori primer iz Peći, kada su u Goraždevcu na teroristički najgrublji način izvršen akat na onu decu, kako su zbrinuta deca koja su poslata u bolnici u Peći. To jasno govori...

#### KRYETARI I KUVENDIT:

A don të flasësh për ligjn apo për politikë?

#### RANDJEL NOJKIĆ:

Govorim o zakonu, konkretno zakonu zašto su razlike u stavovima našim, i zašto su razlike u donošenju na ovakav način. Prema tome, taj primer veoma jasno govori zašto je polarizacija u ovoj oblasti. Postavlja se sasvim logično pitanje: kako će jedna zajednica da organizuje jednu veoma važnu društvenu delatnost u uslovima kada se, recimo pravi projekat nacrt ovog zakona a u radnoj grupi nema nijednog srpskog stručnjaka. Da li to znači da srbi nemaju stručnjake, ili to znači diskriminacija tih stručnjaka. Eh, zato, nemamo stručnjake! To je vaše mišljenje. Eh, zato, srpski eksperti imaju moralnu nacionalnu i svaku drugu obavezu prema svojoj zajednici da organizuju zdravstvo u svojoj zajednici i zato se dešava ovo što se dešava, i zato srpska Koalicija «Povratak» će razmišljati kako će da glasa i verovatno će glasati i protiv ovog zakona kao i protiv drugih zakona. Hvala.

#### KRYETARI I KUVENDIT:

A bën pak qetësi ta shfrytëzoj të drejtën time për replikë por nuk do të replikoj. Vetëm po i them të qartë një çështje. Parlamenti i Kosovës kurrë më nuk do të nxjerrë ligje për "Kosovë e metohi". Për Kosovë po, të mira dhe bashkërisht. Ju falemnderit. Blerim Baruti dhe Fadil Kryeziu, një minut vetëm e ka kërkuar...



BLERIM BARUTI:

Falemnderit, i nderruari zoti kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë,

Pra, me anën e këtij ligji të motojmë që të dilet nga kjo situatë duke mundësuar ngritjen e cilësisë në menaxhim, në ofrimin e shërbimeve shëndetësore më të mira, duke i avancuar mënyrat e mekanizmit të sistemit, të përcjelljes dhe kontrollit shëndetësor në Kosovë.

Ajo çka më shtyri më tepër të bisedoj, ishin nga parafolësit, për të cilët, duke analizuar projektligjin dhe duke u mbështetur në gjendjen faktike, konsideroj se do të zbatohet në tërë territorin e Kosovës, edhe në spitalin regional të qytetit të Mitrovicës, në të cilin institucion shëndetësor nuk kanë qasje personeli shqiptar dhe mbi 130 mijë qytetarë të qytetit të Mitrovicës, edhe pse pas luftës ishte nën patronatin ndërkombëtar, njëherit ishte edhe i ngritur flamuri i Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe garantohej kujdes dhe veprimtari shëndetësore për të gjithë në mënyrë ta barabartë.

Pra, edhe një pjesë që këtu s'e kam pa në ligj dhe që nuk e kam hasë - mospërëfshirja e qendrave regjionale mjekësore shëndetësore, të cilat nuk e dija janë të përfshira diku apo jo. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Fadil Kryziu.

FADIL KRYEZIU:

Ju falemnderit fort i nderuari kryetar, të nderuar deputet,

Unë zakonisht do të filloj në bazë të shprehi, të flas për atë që nuk shkruhet në ligj, sepse për atë që shkruhet në ligj, ka mjaft diskutantë.

Mendoj, zonja ministreshë se si propozuese e ligjit keni harrue një diçka shumë të rëndësishme që Kosova do të duhej të marrë masa paraprake, besoj tash në këtë kohë ne nuk ballafaqohemi me atë problem, është çështja e klonimit në njerëz. Përveç kapitullit 7, ku thuhet – hulumtimet klinike në njerëz, mendoj se duhet të përfshihen – ndalesa e eksperimenteve në njerëz siç është klonimi në Kosovë sepse në kohën kur në shtetet me mjekësi, me shkencë të përparuar ndalohet një gjë e

tillë, mund të gjendet terren i përshtatshëm, domethënë, që të vihet në Kosovë ose siç edhe ndodhë në disa shtete të rajonit, së paku mund të jenë spekulime mediatike këto. Ju falemnderit.

### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Edhe unë e kam harrue, është paraqitur për replikë, zoti Lirak Çelaj.

Urdhëroni, zoti Lirak Çelaj.

### LIRAK ÇELAJ:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë,

Unë këtu dola të replikoj për hirë të së vërtetës pasi këtu kemi shumë monitorues ndërkombëtar. Ne e dijmë se raportet, edhe në Kombet e Bashkuara edhe në Këshill Evropian të gjitha janë në disfavor tonin dhe fatkeqësisht pala serbe në këtë aspekt po na mund neve. Do të thotë me propagandë dhe duke plasuar të pavërteta, ata shpesh po dalin edhe këtu në foltore të Parlamentit tonë. Dhe, ne po heshtim, duke dashur që të mos marrin kahje tjetër, e që pajtohem, por – nuk është mirë të merremi me këto gjëra, por atëherë do të duhej ndoshta kryetari t'iu ndalte fjalën kur ata devijojnë nga tema, do të thotë sikur që ishte rasti sot – nuk foli për mjekësi por për politikë.

Për hirë të së vërtetës, por prap po them për të tjerët, e dinë edhe këta të tjerët dhe ju e dini... Nuk është puna që ne nuk po i pranojmë serbët në shoqërinë tonë, por është që ata nuk po dojnë të integrohen në shoqërinë kosovare. Do të thotë, unë kisha dashur të di se çka bëjnë ata që të integrohen në shoqërinë tonë? Them: asgjë. Përkundrazi, ata po bëjnë çmos që të ndahen prej nesh. Me fjalorin që përdoret këtu, me termet "Kosovë e metohi", me mospranimin e dokumentave të Kosovës, me thënien e kërcnimit "se do të kthehen me ushtrinë serbe këtu përsëri", me fjalorin që ma kujton 81-shin edhe pse unë kam qenë atëherë shumë i ri – që po dhunohen, me rastin e Martinoviçit, e me çka ta di unë, me dëbimet, me presionet dhe ajo dihet ku na ka sjellë. Na ka sjellë në luftën e vitit 91 në Kroaci e Bosnë, pastaj edhe në Kosovë në këtë luftë.

Unë kisha kërkuar që kryetari t'ua ndalojë këtë dhe serbët ta harrojnë këtë punë, të fillojnë, menjëherë të mendojnë ku do ta shohin veten në shoqërinë kosovare dhe shqiptarët e Kosovës tanimë e kanë pranuar këtë fakt se ata janë pjesë e Kosovës dhe kanë filluar t'i pranojnë ata si pjesë të Kosovës, por serbët nuk po dojnë që të jenë të tillë.

Fakti që u përmend për rastin e spitalit nga kolegja që është pranuar një..., ai tregon që këta të tjerët nuk dëshirojnë që të vijnë në spital, se po të vijnë do të trajtohen në mënyrë të mirë, e nuk thotë që nuk po pranojnë këta të tjerët. Ka shumë siguri për t'u thënë, ndoshta edhe tjerët mund ta plotësojnë... Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Sa për informim. Unë sot tre herë e kam shkyçur mikrofonin, por kushtet teknike janë..., njerëzit kanë fuqi zëri shumë të madhe dhe çka? Ka edhe mënyra tjera, por në demokraci nuk preferohen, sepse me rregullore janë të parapara edhe mundësitë tjera...

Në emër të Komisionit doktor Sejduallah Hoxha, dëshiron.

#### SEJDULLAH HOXHA:

Të falemnderit zoti kryetar,

Unë vetëm një përgjegje kolegut, në emër të Komisionit, pasi që u konsultuam paraprakisht. Ai tha se pjesëtarët e minoritetit serb janë të diskriminuar. Nuk është e vërteta kjo, nga që, që nga themelimi i Parlamentit deri në ditën e sotme, përkundër asaj që janë të favorizuar, pra dy anëtarë janë në Komisionin e shëndetësisë, asnjëri nga ta nuk ka marrë pjesë në mbledhje të Komisionit për shëndetësi. Pra, vetë fakti tregon se nuk janë të interesuar për zhvillim institucional por janë për paralelizëm. Ju falemnderit.

#### KRYETARI I KUENDIT:

Ju falemnderit. I kemi dëgjuar të gjitha grupet parlamentare dhe i kanë dhënë përkrahje. Asnjë decidivisht nuk e ka munguar përkrahjen. Të gjithë deputetët që janë paraqitur e kanë marrë fjalën, prandaj tash duhet të deklarojemi e t'i japim përkrahje në parim.

Kush është për? Ju falemnderit shumë.

A ka votë kundër? Dy vota kundër. Ju falemnderit.

A ka abstenime? Numëroni votat. 12 abstenime.

Prandaj, konsideroj se u miratua në parim ligji. Ju falemnderit.



---

 Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For .....Shumica – Vecina – Majority.....
  - Kundër – Protiv – Against .....02.....
  - Abstenime – Uzdrzani – Abstained.....12.....
- 

Mendoj se nuk duhet të japim pauzë, edhe pse jemi të lodhur të gjithë, por të vazhdojmë.

Pika e tretë e rendit të ditës është: - Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve.

Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës i ka bërë rekomandimet për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve në disa gjykata të Kosovës.

Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, si komision funksional, i ka shqyrtuar këto propozime dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin sipas raportit për të dhënat shtesë dhe sipas raportit të rregullt.

Prandaj, nëse dikush don në emër të Komisionit, le të urdhëron. Kryetari po shoh se nuk është në sallë. Nëse s'ka, atëherë votojmë për raportin.

Kush është për rekomandimin e Komisionit, ju lutem? Ju falemnderit shumë.

A ka kush kundër rekomandimit? Një votë kundër.

A ka abstenime? 13 abstenime.

Trembëdhjetë abstenime, një votë kundër prandaj konsideroj se është aprovuar rekomandimi i Komisionit përkatës.

---

 Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For .....Shumica – Vecina – Majority.....
  - Kundër – Protiv – Against .....01.....
  - Abstenime – Uzdrzani – Abstained.....13.....
-

Kalojmë në pikën e katërtë: - Përgjigjet në pyetjet e deputetëve.

Dragisha Kërstoviq në emër të Grupit Parlamentar ka diçka.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, dame i gospodo poslanici,

Nekoliko poslanika Poslaničke grupe Koalicije "Povratak" je Vladi Kosova postavilo pitanje u vezi sa upotrebom logoa na zvaničnim dokumentima Vlade i s tim u vezi dobijen je odgovor, kojim Koalicija "Povratak" nije zadovoljna. Odgovor je naime korektan, mislim da je sadržina njegova u skladu sa onim što stvarno jeste, ali je očigledno da se logo koji se upotrebljava na dokumentima Vlade, na memorandumima Vlade upotrebljava nelegalno. Naime, u tački 7. poglavlja prvog, Ustavnog okvira za privremenu samoupravu na Kosovu, piše da se "privremene institucije samouprave...", da će privremene institucije samouprave koristiti samo one simbole koji su utvrdjeni ili koji budu utvrdjeni zakonodavstvom UNMIK-a. Vlada daje odgovor u kojem između ostalog kaže: 23 juna 2003. godine sva ministarstva i institucije na Kosovu dobile su informaciju sa ovog sastanka, dostavljamo vam kopiju loga koji će se koristiti u privremenim institucijama Kosova tako kako je predviđeno Ustavnim okvirom. Komisija, sastavljena od predstavnika kosovskih institucija, UNMIK-a, Akademije nauka i umetnosti, civilnog društva i predstavnika manjinskih zajednica, je izabrala logo. Logo je prihvaćen i od strane Evropske zajednice i UNMIK-a. Ne znamo kako je to prihvaćen i ne znamo kako je to ovaj logo zvanično na... kako se stavlja na zvanična dokumenta Vlade?

Ne vidimo da je bilo kojom uredbom UNMIK odobrio upotrebu ovog loga, a osim toga, imamo i primedbu da je u Komisiju za izradu ovog loga učestvovao samo izvesni Dejan Dejić, koga lično ne poznajem i za koga ne znam kako je dobio mandat da učestvuje u ovoj Komisiji i da predstavlja, na bilo koji način, Srpsku zajednicu i njene interese u izradi ovog loga.

Dakle, moje je mišljenje i mišljenje Koalicije "Povratak" da se ovaj logo protivpravno upotrebljava i mi ćemo, naravno, posle ovoga zatražiti dalja tumačenja i stavove onih koji su po Ustavnom okviru ovlašćeni da svojim zakonodavstvom utvrđuju ambleme u skladu sa odredbom tačke 7. prvog poglavlja Ustavnog okvira. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Do të thotë në pikën 4.1, te unë është domethënë 5.1 në fakt, është dhënë përgjigje me shkrim, sipas kërkesës, nga kryeministri. E konsiderojmë përgjigje të plotë dhe të duhur. Pastaj e kemi ...Ende s'e kemi krye të parën, e pastaj do të ...

Do të thotë, në pyetjen e parë, në vërejtjen që ka bërë Koalicioni "Kthimi" në kohë është përgjigjur kryeministri, është përgjigjur konform të gjitha rregullave që funksionojnë në institucionet në Kosovë dhe është përgjigje valide, por është Koalicioni "Kthimi" ose individët që nuk mund ta vazhdojnë çka dëshirojnë më tutje.

Pastaj, është përgjigja me shkrim e kryeministrit në pyetjen e deputetit Alush Gashi. Profesor Gashi ka vërejtje apo sygjërim, apo çka doni. Urdhëroni...

ALUSH GASHI:

I nderuari kryetar i Kuvendit,

Unë vetëm dua ta shfrytëzoj të drejtën që ma mundëson Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës. Me inisiativë të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në seancë plenare u diskutua çështja e ligjit për zgjedhje. Ky Kuvend ka marrë vendim që Qeveria të dalë me ligj për zgjedhje. Qeveria deri më sot, në krye me kryeministrin, nuk ka demonstruar kompetencë në këtë çështje. Pas kalimit të a fatit të paraparë për përgjigje në projektligj pas vendimit në seancë plenare, unë iu kam drejtua me pyetje kryeministrit të Qeverisë së Kosovës që të shpjegojë se në cilën fazë është përgatitja e projektligjit.

Zoti kryetar, në vend të përgjigjes së kryeministrit, mua më ofrohet një material i shaptilografuar me datë 17 prill 2003. Mendoj se kjo është një papërgjegjësi e plotë e kryeministrit ndaj këtij organi, dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK, e ftoj kryeministrin në interpelancë. Ju falemnderit zoti kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Do të procedohet sipas rregullës. Sigurisht se është e drejtë që në një shaptilografim të një date të kaluar ndoshta ndonjë gabim teknik, unë them nëpër sekretari të Qeverisë ose të Parlamentit..., prandaj do të procedohet sipas rregullave që kërkohen.



Mirë, ju keni të drejtë. Grupi parlamentar e fton, unë thash do të procedohet sipas rregullës dhe procedurës. Tjetër nuk di çka me ju thënë?

Pastaj e kemi: - Përgjigja gojore e ministrit të mjedisit dhe planifikimit japësinor, zotit Ethem Çekut në pyetjen e deputetit Ismajl Kurteshi.

Zoti ministër, urdhëroni.

### ETHEM ÇEKU:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Duke shpreh konsiderata të larta për punën dhe angazhimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe duke pas rrespekt të veçantë ndaj deputetëve, pas pranimit me shkrim të pyetjes nga deputeti Ismajl Kurteshi, e cila ka të bëjë me ndotjen e mjedisit, ruajtjen e tokës bujqësore dhe prerjen e pakontrolluar të pyjeve, po paraqesim përgjigjen tonë sot në këtë seancë të Kuvendit me qëllim të dhënies së kontributit tonë edhe pse pyetja e zotit Kurteshi si tërësi kap edhe sfera të cilat nuk janë përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Vlerësohet se një ndër kërcnimet më serioze ndaj të ardhmes së bujqësisë në Kosovë është ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore. Para luftës mbi 1.000 hektarë në vit janë konvertuar nga toka bujqësore në tokë ndërtimore dhe kjo shifër është në rritje e sipër. Nga sipërfaqja e përgjithshme e Kosovës, 53% është tokë e punueshme, 41% janë pyje dhe 6% të tjera. Humbja e tokave pjellore po ngjanë me ndërtimin e qyteteve, vendbanimeve si dhe me eksploatimin e mineraleve që edhe po ndikon në zvogëlimin e tokave pjellore dhe në shndërrimin e deponimeve të mëdha të cilat në shumicën e rasteve kanë zënë sipërfaqe të mëdha të tokave bujqësore.

Me këtë rast mund të përmendim deponinë e hirit në KEK dhe djerrinat e deponisë së Trepçës. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në definimin e sistemit të planifikimit të ndërtimit të qyteteve dhe vendbanimeve të qyteteve përshkruan ndërtimin racional dhe zhvillimin e qëndrueshëm ku veçanërisht i kushtohet kujdes ndalimit të shndërrimit të tokës pjellore në kualitete me atë ndërtimore. Mosdegradimeve të tokës prej eksploatimit të mineraleve do t'i kushtohet kujdes i veçantë përmes parimeve të licencimit, konsensioneve dhe lejeve të eksploatimit në kuadër të një zhvillimi të qëndrueshëm. Degradimet e trashiguara nga eksploatimet e mëhershme do t'i rikultivojnë dhe kthejnë në një tokë të përdorur, ku në vijim është projekti për kultivimin dhe stabilizimin e një pjese të deponisë së hirit në KEK donacion i Qeverisë Italiane dhe Agjencionit Evropian, ku një pjesë e punëve është në kryerje e sipër.

Ligji për planifikim hapësinor obligon komunat që urgjentisht të përcaktojnë tokën kualitative bujqësore në të cilën rreptësisht është ndaluar ndërtimi. Në anën tjetër, për çdo ndryshim eventual të parapara me plan, paraprakisht duhet hartuar vlerësimin e ndikimit mjedisor, social dhe ekonomik. Njëkohësisht definohej rregullat për ndalimin e ndërtimeve pa leje, ku së shpejti do të dalin rregullataiva për ndalimin e përhershëm të ndërtimeve pa leje.

Një çështje tjetër që është te ne po ashtu e rëndësishme është çështja e lumenjve në Kosovë dhe cila është gjendja e lumenjve dhe e ujërave në Kosovë. Në Kosovë janë katër pella të lumenjve, por lumenjt kryesor janë relativisht të vegjël. Duke u bazuar në analiza kimike dhe mikrobiologjike të bëra nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, kualiteti i ujërave të lumenjve është në nivelin e duhur. Sasia e ujit në Kosovë në disa rajone është shumë më e vogël se sa nevoja për shfrytëzimin e tij. Në Kosovë vetëm 44% e popullatës së përgjithshme dhe 8.4% të popullatës rurale kanë qasje në rrjetin e ujësjellësit. Llogaritet mbi 50% përdorin puse apo bunare. Popullata në vende rurale është në gjendje mjaft të vështirë, sa i përket aspektit të furnizimit me ujë të pijshëm. Analizat e bëra nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, tregojnë një kualitet jo të mirë të ujit të puseve, të cilët kryesisht shënojnë ndotjen organike, por edhe ndotjen inorganike, sidomos tek fshatrat që gjenden në rrethet industriale. Me fjalë të tjera, pusët në shumicën e rasteve janë në gjendje të mjerueshme edhe pse ka pasur disa donacione nga organizatat e ndryshme botërore për përmirësimin e kualitetit të ujit të pijshëm duke bërë dezinfektimet e tyre, por ajo është vetëm një element i vogël në përmirësimin e gjendjes. Ndotja kryesisht vjen nga vendbanimet industriale ku ujërat e zeza dhe ujërat nga proceset teknologjike të industrive lëshohen të patrajtuara në lumenj.

Në Kosovë vetëm 28% e popullatës është kyçur në rrjetin e kanalizimit, ndërsa nëpër vende të vogla dhe fshatra shkarkimet e ujërave të zeza bëhen në lumenj përmes kanaleve, që edhe shkakton ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore dhe si rezultat i gjithkësaj kemi edhe paraqitjen e epidemive të ndryshme.

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, definojnë projektet për sistemin e trajtimit të ujërave të zeza, që është prioritet në mbrojtjen e ujërave, veçanërisht të qyteteve të mëdha dhe si rezultat kemi vendosjen e sistemit të trajtimit të ujërave industriale në Trepçë dhe në Parkun industrial të Mitrovicës; studimet e bëra në ndërtimin e stacionit për trajtimin e ujërave të zeza në Pejë, financuar nga Agjencioni Evropian i Rindërtimit dhe dy pilot-projekte për ndërtimin e stacioneve për trajtimin e ujërave të zeza.



Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor është angazhuar edhe në kadastrin e ujërave industriale në bazë të të cilit do të definohen prioritetet se cilat objekte industriale do të duhej të ndërtojnë patjetër sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura dhe projektet e tilla do të përcillen nga ana jonë. Meqenëse këto janë investime të mëdha, do të definohen programet duke përfshirë të gjitha resurset e mundshme prej atyre lokale, qendrore dhe ato donatore.

Ministria e Mjedisit definon sistemin monitorues i cili e përcjell gjendjen e ujërave të lumenjve dhe përmirësimet që do të bëhen nga masat e lartpërmendura.

Sa i përket çështjes së pyjeve, në këtë drejtim ne jemi munduar vetëm në bazë të kompetencave që i kemi si Ministri për parqet nacionale. Prandajm, pas shpalljes së kësaj zone, do të thotë është fjala për Parkun Nacional Bjeshkët e Nemuna, pas shpalljes së kësaj zone si zonë e interesit të veçantë, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor është e obliguar që përmes planit hapësinor për zona të veçanta t'i parashehë të gjitha aspektet e mbrojtjes dhe zhvillimit të kësaj zone. Përmes kësaj forme do të kontribuojmë edhe në ruajtjen e sistemit pyjor në Kosovë. Për tejkalimin e kësaj situatë jemi duke punuar në hartimin e bazës ligjore, ngritjen e kapaciteteve institucionale, vendosjen e drejtë të prioritetëve, sigurimin e financave dhe bashkëpunimin me institucione vendore dhe ndërkombëtare dhe me donatorë. Ju falemnderit për vëmendje.

#### KRYETARI I KUVENDIT:

Zoti ministër ju falemnderit për fjalë të argumentuara dhe të gjera. E kemi përgjigjen me shkrim në kllapa (gojore) të ministrit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, zotit Goran Bogdanoviq. Ai, aktualisht nuk po e shoh se është në sallë. Zoti Kurteshi e ka fjalën.

#### ISMAJL KURTESHI:

Së pari falënderoj ministrin Çeku për përgjigjen e vërtetë dhe të thuktë, kurse sa i përket përgjigjes me shkrim të ministrit të bujqësisë, unë nuk kam kërkuar përgjigje me shkrim por kam kërkuar përgjigje me gojë dhe përgjegjen-që-ma-ka dhënë me shkrim nuk është përgjegjur në krejt atë që kam pyetur, prandaj kërkoj nga ministri i bujqësisë që në mbledhjen e ardhshme të paraqitet këtu dhe t'i sqarojmë disa çështje të cilat vërtetë do të duhej të sqaroheshin.

Dhe, meqë jam këtu, ju lutem, zoti kryetar, më lejoni që ta bëj vetëm një propozim.



Për shkak të, konsideroj, keqpërdorimit shumë të shpeshtë të kësaj foltoreje, propozoj që në njërën nga mbledhjet e ardhshme të futet si pikë e rendit të ditës një pikë në të cilën do të trajtohen problemet me të cilat po ballafaqohen qytetarët e Kosovës dhe si të zgjidhen ato. Këtë po e them sepse shpesh foltorja e Kuvendit keqpërdoret nga disa deputetë të grupit "Kthimi" të cilët edhe po akuzojnë pa bazë institucionet e Kosovës, po i ngrisin tensionet dhe po krijojnë një imazh vërtetë të keq për Kosovën. Duke diskutuar ndoshta pa tensione njëherë dhe të gjithë me argumente dhe me kundërgargumente do ta përfundojmë këtë tendencë e cila vërtetë është e dëmshme për të gjithë ne. Ju falemnderit.

### KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Hydajet Hyseni si anëtar i Kryesisë. Ka pyetje, siç thotë, të deputetëve, do t'na thotë ai se çka.

### HYDAJET HYSENI:

S' domend se diçka kam! Zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Pak më parë ne dëgjuam një deklaratë të fortë dhe goxha politike të drejtuar kundër Qeverisë dhe unë nuk shoh gjë të keqe që ne ta inaugurojmë edhe këtë mënyrë të reagimit dhe të veprimit në Kuvend. S'ka gjë të keqe. Vetëm ajo që na duhet është që të mos lejojmë tirada politike pa i rrespektuar së paku ato rregulla për të cilat jemi marrë vesh.

Unë dua të tërheq vërejtje që të mos na bëhet tashmë kjo, sikur ajo puna e minit, praktikë se ne e kemi të pasqaruar çështjen e pyetjeve, por megjithatë Rregullorja me të cilën ne punojmë e lejon mundësinë e parashtrimit të pyetjeve për përgjegje me shkrim kryeministrit ose ndonjë ministri tjetër, por po tërheq vëmendjen në vijim lidhur me fushën e tij të përgjegjësisë. Qeveria jonë dhe kryeministri, për fat të keq, nuk ka kompetenca në sistemin zgjedhor. Ju e dini të gjithë këtë mirë. Nuk mund të lejojmë ne që dikë edhe ta bëjmë prift, edhe t'ia rruajmë mjekërren, edhe ta akuzojmë pse s'ka mjekërr, ju lutem. Kurse, sa i përket interpelancës, nuk ka gjë të keqe që ta ftojme edhe ministrin edhe kryeministrin, por dua që t'ua jap rastin që të dëgjohemi, në interpelancë. Por, megjithatë interpelanca nuk kërkohet ashtu fët e fët. Rregullorja jonë e parasheh shumë qartë që interpelanca parashtrohet në formë të shkruar dhe përmban këto elemente: formulimin preciz të çështjes që është lëndë e interpelancës; konkluzionin që propozohet lidhur me të, së bashku me arsyetimin; emrin e mbiemrin e deputetit, e tjera, e tjera. Angazhohem që t'i rrespektojmë rregullat para se të dalim me deklarata politike. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Profesor Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar. Tomë, leje amanin ta kam. Po bëni pyetjet me procedurë.

SABRI HAMITI:

Zotni kryetar,

Unë do t'i them vetëm dy-tri fjalë dhe fjalët natyrisht do t'i them pas paraqitjes së zotni Hydajet Hysenit se nuk do të kishte edhe nevojë t'i themi.

Çdo punë që bëhet në bazë të rregullave demokratike duhet të bëhet në bazë të rregullave demokratike. Mënyra se si flasim njerëzit, nëse bëjmë analiza psikologjike, atëherë do të shkojshim në punë tjera se dikush ka më shumë temperament, dikush më pak, por duhet të shihen argumentet.

Ajo që në emër të Grupit tonë e paraqiti profesor Alush Gashi, ajo është pasojë e kërkimeve shum mujore të përgjegjësive rreth këtij problemi. Atë Rregullore, me të cilën punojmë, ne e rrespektojmë deri në pikën e fundit dhe do ta rrespektojmë. Mirëpo, Hyseni, si anëtar i Kryesisë së Kuvendit duhet të brengoset sa realizohen vendimet e Kuvendit dhe unë mendoj shumë që nuk ka nevojë kryeministri as Qeveria për avokaturë nga ana e Kuvendit. Ata janë të detyruar të përgjigjen në vendimet e Kuvendit. Vendimi i Kuvendit, i diskutuar dhe i votuar këtu, dhe i dekretuar nga kryetari i Kuvendit që brenda tre muajsh duhet të jipet përgjigje, nuk është kryer. Ne kërkojmë që të dilet dhe të argumentohet pse. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Unë thash që do të procedohet dhe kërkohet, prandaj mos t'i ngrisim temperaturat pa asnjë arsye. Deputetët procedimin e pyetjeve e dijnë, le të procedojnë sipas rregullores dhe jo ta marrin fjalën pastaj këtu.

Për fund edhe diçka të them. Nuk është e hijshme, një ministër të jetë tërë kohën këtu dhe kur i vjen radha me treguar përgjegjësi ndaj Parlamentit, sigurisht se ka patur ndonjë arsye, por nuk justifikohet ajo.

Tomë, nuk ka më fjalë, as pyetje as kurgjë. Me shkrim i bëni, ju lutem.

Kalojmë në pyetjen tjetër - Propozimi i rendit të ditës për Seancën plenare më 20 nëntor 2003:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sportin;
- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për kadastër;
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transportin rrugor.

Ju falemnderit për pjesëmarrje. Shihemi në mbledhjen e ardhshme.

Seanca përfundoi në orën 12,25.

---

E transkriptoi: RT, Zyra E-04, tel. 211-860